

Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**ÇËSHTJE FETARE,
SHOQËRORE, POLITIKE
BASHKËKOHORE
NË PESHOREN E KUR'ANIT**



Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

ÇËSHTJE FETARE, SHOQËRORE, POLITIKE BASHKËKOHORE NË PESHOREN E KUR'ANIT

(Studim analitik i tefsirit të prof. Sejjid Kutubit)

Punim shkencor për simpozium botëror
“KUR'ANI KERIM DHE ÇËSHTJET
BASHKËKOHORE SHOQËRORE”
në Terengano, Malajzi
1-2.12.2012

Fakulteti i Sheriatit dhe Studimeve Islame
Universiteti i Katarit
2012

Përktheu nga arabishtja
Doc. Dr. Muhamed Mustafa

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Mendo gjithmonë se:

“Islami është metodë, metodë e jetës, e jetës njerëzore objektive me të gjitha parimet e saj, metodë që përmbledh konceptin e besimit, i cili komenton natyrë e (ekzistencës), përcakton pozitën e (njeriut) në këtë ekzistencë ashtu siç e cakton qëllimin e ekzistimit të tij njerëzor... I përmbledh sistemet dhe organizimet reale që grafullojnë nga koncepti i tillë i besimit, që mbështeten në të dhe që përfaqësojnë pasqyrën reale që vërehet në jetën e njerëzve, si sistemi i moralit dhe burimi prej të cilit burojnë parimet mbi të cilat mbështeten, pushteti që përfitohet prej tyre, sistemi politik, format e karakteristikat e tij, sistemi ekonomik me filozofinë dhe problematikat e tij, sistemi ndërkombëtar në marrëdhëniet dhe relacionet e tij...”¹

“Sa i përket “sistemit islamik” që të mbizotërojë në vetë njerëzinë, qofshin prej atyre që e pranojnë Islamin apo jo, duhet orvatur formimin dhe mbrojtjen e këtij sistemi, duke i lënë njerëzit të lirë në këtë aspekt brenda suazave të besimeve të tyre. E gjithë kjo mund të realizohet vetëm nëse ka pushtetar të mirë, ligj të mirë, sistem të mirë që e mbron prej secilit që tenton të sulmojë lirinë e da’vetit dhe besimin e lirë në tokë!”²

Prof. Sejjid Kutub

¹ *El-Mustekbelu li hadheddin*, f. 2.

² *Hasaisut-tesavvuril-islamij*, f. 14.

ÇËSHTJE FETARE SHOQËRORE POLITIKE BASHKËKOHORE
NË PESHOREN E KUR'ANIT
Lexim analitik i tefsirit të prof. Sejjid Kutubit

REZYME

Kishte të drejtë Imam Sujutiu kur e tha thënien e tij të njohur: “Vërtetë libri ynë Kur’ani është burim dhe grafullues i shkencave, qark i diellit dhe lindjes së tyre, dhe aty e ka venduar Zoti i Madhëruar diturinë për çdo gjë...”

Zoti i Madhëruar shpalli Kur’anin Fisnik për t’i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë: “*(Ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t’i nxjerrish njerëzit prej errësirave në dritë; (t’i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të Fuqplotit, të Falënderuarit*” (Ibrahim, 1).

Zoti i Madhëruar e bëri Kur’anin mrekulli të gjallë që do të vazhdojë deri në Ditën e gjykimit. S’ka dyshim se ngjyrat e mrekullisë së Kur’anit janë të ndryshme dhe të llojllojshme. Aty mund të gjejmë mrekulli shkencore, mrekulli ligjore, mrekulli historike, etj. Pasi që Kur’ani është mrekulli hyjnore për çdo kohë dhe çdo vend, libër i tërë njerëzisë dhe libër i të gjitha kohërave, atëherë metodologjia hyjnore që është e qartë dhe ndikuese, është ajo që kërkohet e që ju mungon shumicës së njerëzve në këtë kohë. Kjo metodologji hyjnore me karakteristikat e veta është universale, sepse i përmbledh sistemet etike, shoqërore, politike dhe se nevoja e njerëzve për këtë metodologji është shumë e madhe. Karakteristikat dhe virtytet e kësaj metodologjie hyjnore janë theksuar në Kur’anin Famëlartë dhe në sunnetin e pastër, dhe një numër i madh i mendimtarëve dhe i dijetarëve të kaluar e bashkëkohorë janë marrë me sqarimin, komentimin dhe shqyrtimin e tyre. Pjesa më e madhe e sistemeve bashkëkohore shoqërore e politike janë sisteme pastër njerëzore pozitive (apo sisteme me trashëgimi xhahilite), siç thotë profesori Sejjid Kutub.

Islami duhet të gjykojë e jo të gjykohet, udhëheqës e jo i udhëhequr, dhe kjo metodologji n dryshon nga metodologjia pozitive njerëzore që e njeh Evropa. Në metodologjinë hyjnore nuk ka dallim në mes fesë, dynjasë dhe qytetërimit, nuk ka kontradikta në mes nevojave të shpirtit, trupit dhe trurit. Sistemi islamik është sistem i vetëm që e shpëton botën nga lodhja intelektuale, etike, ekonomike e politike, ofron lirinë, qetësinë psikike, intelektuale dhe shoqërore për të gjithë njerëzit. Pra, patjetër t’i kthehemi sistemit të vetëm islamik për të formuar gjeneratë me zemër të pastër, me tru të singertë, me koncept të kthjelltë, me ndjenja të pastra dhe të qetësuara.

Natyra e kësaj feje refuzon deponimin e njohurive në frigoriferët e ftohtë të trurit, dhe ne sot, patjetër të përfitojmë nga metoda e gjeneratës së parë në leximin e Kur’anit Fisnik për të mësuar, për të realizuar, për punë dhe për sukses. Gjeneratat bashkëkohore janë formuar nga metoda e studimit dhe kënaqësisë.

Ky parim shkencor do të orvatet me ndihmën e Zotit që të përgjigjet në disa pyetje të tilla nëpërmes shqyrtimeve dhe studimeve të mia të tefsirit të profesor Sejjid Kutub (Fi dhilalil-Kur’an) dhe disa veprave të tjera. Prej Zotit kërkoj ndihmën e suksesit, udhëzimin dhe shpëtimin. Paqja qoftë mbi ju, mëshira e Zotit dhe begatitë e Tij!

Terminologjia kryesore e këtij hulumtimi: metodologji, legjislacion, karakteristika, sisteme islame, xhahilijet (inJORANCË).

Në emër të Zotit, Bamirësit të Përgjithshëm dhe Mëshirëbërësit!

HYRJE

Falënderimi i takon All-llahut, të cilit i takojnë qiejt, Zotit të botëve, i Vetëm në të gjitha cilësitë e atributet, i Mëshirshëm dhe Mëshirëbërës mbi të gjithë nevojtarët dhe skamnorët, Posedues i Ditës së gjykimit, i cili i shpërblen mirëbërësit dhe i dënon keqbërësit, vetëm Ty të adhurojmë dhe në Ty mbështetemi gjatë obligimeve tona. Na udhëzo në rrugë të drejtë të të gjitha udhëzimeve, në rrugën që e pranon Ti në çdo gjendje e çdo pozitë, e jo në rrugën e të hidhëruarve e as të humburve nga njerëzit injorantë, të devijuar. Salavatet për Muhammedin, i pajisur me mrekullitë dhe shenjat më të mira, mbi familjen e tij, mbi sahabët e tij dhe mbi gratë e tij të pastra, nënat e besimtarëve dhe besimtareve dhe përshëndetje të madhe! O Zoti ynë, na nxjerr nga errësirat e iluzionit dhe na ndero me dritën e të kuptuarit, na bën të kuptojmë diturinë, na jep moral të mirë, na nxjerr nga dyshimet e hamendjeve e na dërgo e na dërgo në kopshtet e të vërtetave dhe fakteve. O Zoti ynë, Ti vërtet je i Gjithëdijshtëm, i afërt, përgjegjës ndaj lutjeve!

1. Rëndësia e punës me Kur'anin Famëlartë duke marrë si udhëheqës gjeneratën e zbritjes së Kur'anit (Selefit të devotshëm)

Zoti i Madhëruar e ka bërë Kur'anin Famëlartë burim të krenarisë dhe autoritetit të muslimanëve. Zoti i Madhëruar thotë: *“A nuk e kuptoni se Ne ua shpallëm librin në të cilin gjendet krenaria juaj?”* (Enbija, 10).

Disa dijetarë thonë se ky ajet ka të bëjë me nderin dhe fuqinë tuaj në dynja. Ai që ecë rrugës së selefit të devotshëm mbështetet për çdo gjë në të si në jetën private ashtu edhe në atë publike si dhe në të gjitha çështjet e fesë dhe të dynjasë. Zoti i Madhëruar thotë: *“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht”* (Nisaë, 65).

Mbështetja në Kur'an ishte e plotë dhe e tërësishme pa kurrfarë hutie e hezitimi nga adhurimi ndaj Zotit dhe për t'iu afruar Atij që është i pastër nga të metat e që jep shkallë të larta.

Zoti i Madhëruar thotë: *“Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës”* (Ahzab, 36).

Po ashtu edhe gjenerata e parë që përjetoi shpalljen e Kur'anit, gjegjësisht sahabët dhe tabi'inët e respektuar gjithashtu mbështeteshin në Kur'an për të mësuar dhe për ta praktikuar, për mësim e punë duke e respektuar e nderuar tërësisht këtë metodologji të vërtetë. Ata i hapnin zemrat dhe trurin para se t'i hapnin kalatë dhe fortifikatat. Pas tyre erdhën gjenerata që u hutuan, sepse mbështeteshin në Kur'an vetëm si lexim e kulturë për të mësuar diçka më shumë pa u bekuar nga kjo metodologji e shëndoshë, dhe kështu filluan të dështojnë. Tash ka ardhur koha që ummeti islamik të rimëkëmbet me këtë Kur'an që të jenë të afërmit e Zotit Mëshirëplotë me kuptim e vepër të mirë e me Kur'an duke e pasur si prijës të birin e Adnanit, pejgamberin tonë, Muhammedin a.s.

2. Obligimi i nënshtrimit ndaj Zotit, ndaj Pejgamberit të Tij dhe ndaj udhëheqësve

Për të qenë jeta e njerëzve e rregulluar dhe për të qenë shteti sa më efikas, Zoti i Madhëruar obligon që t'i nënshtrohen Atij, Pejgamberit të Tij dhe udhëheqësve të muslimanëve. Zoti i Madhëruar thotë: *“Binduni All-llahut dhe binduni të dërguarit e kini kujdes (mos kundërshtoni). E nëse refuzoni, atëherë pra, dini se obligim i të dërguarit Tonë është vetëm komunikimi i qartë”* (Maide, 92).

“O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë” (Nisaë, 59).

3. Da'veti i Kur'anit është ndërkombëtar, ndërsa ligjet kur'anore janë për të mirën e njerëzve dhe shteteve

Mëshira e Zotit ishte ajo që caktoi da'vetin islam të kaplojë mbarë njerëzinë. Zoti i Madhëruar thotë: *“Thuaj (Muhammed): "O ju njerëz! Unë jam i dërguari i All-llahut te të gjithë ju. All-llahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës, s'ka të adhuruar tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni All-llahun dhe të dërguarin e Tij, pejgamberin e pashkolluar, që beson All-llahun dhe shpalljet e Tij, ndiqeni rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën”* (A'raf, 158).

Ashtu siç i rregullon Kur'ani çështjet e njerëzve dhe të vendeve, po ashtu rregullon edhe jetën e besimit, shoqërisë, politikës, moralit dhe ekonomisë. Pra, Kur'ani sistemon jetën tonë publike dhe private, na nxjerr nga bota e dyshimeve dhe hamendjeve e na udhëzon në të vërtetën e dritës dhe gjërave faktike. Në këtë kontekst Kur'ani Famëlartë thotë për Pejgamberin a.s.: *“Të dërguarin që ua lexon ajetet e qarta të All-llahut për t'i nxjerrë ata që besuan dhe bënë vepra të mira prej errësirave në dritë”* (Talak, 11).

Ligjet kur'anore kanë në vete urdhra madhështorë e parime të shenjta për të sistemuar jetën tonë të besimit, ekonominë, shoqërinë, moralin e politikën. Në kontekst të besimit e monoteizmit Zoti i Madhëruar thotë: *“Thuaj: "Unë jam vetëm njeri sikurse edhe ju, mua më shpallet se Zoti juaj është vetëm Zoti Një, pra drejtonju Atij dhe kërkonij falje prej Tij. Për idhujtarët është mjerim i madh”* (Fussilet, 6).

Sa i përket drejtësisë dhe shpërndarjes së pasurisë Zoti i Madhëruar thotë: *“All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zeqati etj.) t'ju takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s'kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhet përfituar zemrat (të dobëtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet”* (Teube, 60).

“(Jepni) për të varfrit që janë të angazhuar në rrugën e All-llahut dhe nuk kanë mundësi të gjallërojnë me tokë, duke qenë se ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të rraskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i mërzojnë njerëzit. Pra çkado që të jepni nga pasuria, s'ka dyshim se atë All-llahu e di shumë mirë” (Bekare, 273).

Për mbrojtjen e pasurisë së jetimit dhe ngrënien e saj në mënyrë të padrejtë, Zoti i Madhëruar thotë: *“Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe do të futen në zjarrin e xhehennemit”* (Nisaë, 10).

Zoti i Madhëruar flet edhe për respektimin e urdhrave etike, fetare, për largimin nga gjërat e ndaluara dhe të këqija: *“Thuaj: 'Ejani t'ju lexoj atë që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë”* (En'amë, 151).

Zoti i Madhëruar na këshillon që të ecim në rrugën e Tij të drejtë që përmbledh në vete ligje, urdhra, ndalesa e parime të zbritura përmes gjuhës së Pejgamberit a.s.: *“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni”* (En'amë, 153).

Zoti i Madhëruar po ashtu na kërcënon nëse largohemi apo nëse kundërshtojmë rrugën e Tij të shëndoshë: *“E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kiametit do ta ringjall të verbër”* (Ta-Ha, 124).

4. Dënimi për largimin nga metoda e Zotit dhe gjendja e tashme e ummetit islamik

Për shkak të refuzimit të udhëzimeve hyjnore dhe braktisjes së urdhrave hyjnorë, ummeti islamik, pas hilafetit të rashidinëve e deri më sot, ka jetuar dhe ende jeton herë në mes shpresave për ngritje e prosperitet nga premtimet e ndritshme kur'anore dhe herë në shkallët e rënies së vërtetë, regresit e prapambeturisë. Populli musliman përjeton sot në aspektin regional e ndërkombëtar dobësinë dhe përçarjen e brendshme sektare doktrinar, dështimin industrial, prapambeturin shkencore, stagnimin intelektual dhe humbjen e rrugës e udhëzimit hyjnor, edhe pse i posedojnë të gjitha parametrat natyrore, njerëzore dhe ekonomike. Ata nuk udhëzohen sipas Kur'anit në metodë e punë, as me besimin dhe përqendrimin në Zot, as me aplikimin dhe praktikumin e sunnetit të Pejgamberit a.s. As historia islame bashkëkohore e as ajo klasike nu ka përjetuar periudhë më të dobët e më konfuze se kjo e jetës sonë në këtë shekull (shekulli 20 dhe fillimi i shekullit 21). Si argument më i fuqishëm i kësaj të vërtete të hidhët e të dhimbshme janë luftërat që u zhvilluan në Irak, Afganistan dhe në vendet e Ballkanit (Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni), në vendet e Kaukazit (Çeçeni) dhe lufta që zhvillohet momentalisht në Siri përderisa i shkruaj këto rreshta. Sa turp i madh dhe situatë e pashpresë?! Njëzet muaj tmerr, vrasje e shkatërtime masive dhe gjaku ende nuk po ndalet! Gjuajtjet dhe shkatërrimet janë të vazhdueshme! Në çdo hap ka vrasje dhe viktimë! Britmat e të paafteve, jetimëve, burrave, grave, fëmijëve, pleqve janë anembanë dhe dëgjohen deri në qiell: Mbrojtje! Ndihmë! Thirren të gjallët por nuk ka jetë! A ka ndonjë që iu përgjigjet ftesave të tyre?! A ka ndonjë ndihmës?! A ka kush i mbron?! A ka ndonjë Salahudin?! A ka ndonjë udhëheqës, kryetar apo mbret musliman që i dëgjon dhe u përgjigjet britmave të nevojtarëve?!

Udhëheqësit e muslimanëve janë të gjithë në kontinentin e kohës, por s'kanë mundësi të ndërhyjnë ushtarakisht për të penguar fantazmën esediane dhe mercenarët e pafe të forcave të sistemit sirian kriminelë vrasës e shkatërrues! Lus Zotin që t'u

ndihmojë dhe se vetëm Zoti është i Gjithëfuqishëm! Deri kur do të vazhdojë ky nënçmim dhe kjo katastrofë?! Deri kur do të vazhdojë ky reagim verbal regjional e ndërkombëtar? Këtë e di vetëm Zoti im në librin që nuk të humbë e nuk të harron! Ata janë mbështetur në ligjet njerëzore i presin vendimet e Këshillit të Sigurimit dhe i dëgjojnë deklaratat e përsëritura të Kombeve të Bashkuara dhe të Unionit Evropian, që janë formale, shohin përkrahjen ruse, kineze e iraniane haptazi ndaj këtij sektit alevit, komunist, socialist e laik që shkatërron rrjedhën dhe gjenezën. Për fat të keq, edhe ummeti islamik shpreson që të shpëtojë përmes kushtetutave artificiale njerëzore nga dekadencia e prapambeturia dhe të ngadhënjë. Pra, nuk ka pushtet nga Zoti dhe nuk ka aplikim të rrugës së Zotit e as respektim të Pejgamberit a.s. Nuk ka ngritje të flamurit të xhihadit për të mbrojtur të drejtat dhe autoritetin e muslimanëve! Ata lëshojnë britma për të shpëtuar nga kjo situatë e nuk ka kurrfarë ndihme e as shpëtim. S'ka mbështetje tjetër përveç All-llahut të pastër nga të metat! Ata harrojnë se suksesi, epërsia dhe ndryshimi janë në duart e Tij: *“Këtë (masë ndëshkuese) e bëri ngase All-llahu nuk ishte ndryshues i një begatie, të cilën ia ka dhuruar një populli, derisa të ndryshojë ai vetë në vetvete (të bëhet përbuzës i së mirës) dhe ngase All-llahu dëgjon (çka thonë) dhe di (çka punojnë)”* (Enfalë, 53).

5. Pikat e shqyrtimit në këtë hulumtim

Ky punim shkencor do të orvatet që t'iu përgjigjet disa çështjeve dhe pyetjeve paraprake me ndihmën e Zotit, edhe atë përmes përvojës së një kalorësi të mendjes, tefsirit e da'vetit islamik, profesorit Sejjid Kutub, duke u mbështetur në tefsirin e tij: *“Fi dhilalil-Kur'an”* dhe në disa vepra të tjera, dhe shpresoj se studimet e tilla do t'i nxisin udhëheqësit e muslimanëve në veçanti dhe të gjithë musëlmanët në përgjithësi për të rikthyer autoritetin e humbur të muslimanëve. Lus Zotin për sukses e qëndrueshmëri, Ai është i Madhëruar dhe vetëm Ai është i Gjithëfuqishëm!

6. Arsyeja e zgjedhjes së përvojës së prof. Sejjid Kutub

Numri i tefsirëve në botë është i pafund, dhe pasha jetën time askush nuk mund të gjejë asnjë si *“Dhilali!”* Zoti i Madhëruar ka caktuar që ky tefsir të depërtojë në zemrat dhe në trurin e njerëzve, të jetë i këndshëm për lexuesit si në aspektin regjional ashtu edhe në atë ndërkombëtar pa u takuar me autorin e tij. Këtë e ndien i afërmi dhe i largëti, arabët dhe të huajt, muslimano dhe jobesimtari, politikani dhe laiku, ateisti dhe fetari, ligjëruesi dhe imami, nxënësi dhe profesori, burri dhe gruaja, i riu dhe e reja, i shkolluari dhe fshatari. Ky tefsir nuk do të kishte këtë autoritet sikur të mos ishte përpiluar me sinqeritet e përkushtim të plotë të autorit me vetveten, me Zotin e Madhëruar dhe me besim të plotë në idenë dhe çështjet në të cilat besonte. Ai bënte orvatje dhe shkruante për orvatjet e tij duke i mbrojtur qëndrimet e tij dhe për këtë shkak edhe e pagoi shtrenjtë, gjegjësisht me jetë. Ai e shkroi tefsirin e tij me ngjyrë kimiku dhe me ngjyrë gjaku, e mbushu plotë me sinqeritet dhe e ujiti me ujin e sinqeritetit e guximit dhe e mbrojti me fshehtësinë e besimit (imanit). E llogarisim atë para Zotit si një nga shehidët (martirët), dhe nuk pastrojmë asnjë para Zotit, sepse Zoti është Ai që na llogaritë neve dhe atë.

Pasi që ky tefsir iu takon tefsirëve bashkëkohorë që merren me çështje të besimit, shoqërisë e politikës, duke i tejkaluar mosmarrëveshjet e ngushta filozofike, sektare e tradicionale, duke u mbështetur në mesazhin ndërkombëtar dhe komprehensiv të

Kur'anit, jam i bindur se mendimi i tij komentues ka arritur kulmin dhe cakun përfundimtar, dhe se frytet e tij janë pjekur dhe me lejen e Zotit janë gati për t'u hëngër në të gjitha vendet. Tefsiri i tij meriton të lexohet, studiohet, analizohet, të kritikohet në mënyrë konstruktive dhe të zbulohet. Mendimet dhe orvatjes e autorit të këtij tefsiri janë formuar gjatë përjetimit dhe kuptimit të Kur'anit Fisnik të drejtpërdrejtë për një periudhë të gjatë të jetës së tij. Ai jetoj si komentues e Librit të Zotit dhe si hulumtues i të vërtetës që gjendet në të.

Ata që e kritikuan dhe akuzuan nuk e kanë bërë përmes shkencës së pastër të tefsirit, sepse kjo lëndë është shkencë e pavarur që ka kushte, rregulla, parime, standarde e metoda. Drejtësia shkencore metodologjike është objektive dhe duhet të realizohet përmes rregullave dhe parimeve të shkencës së tefsirit, si dhe të shqyrtohen gabimet dhe lëshimet përmes parimeve të tilla të tefsirit, do të thotë, ne duhet të respektojmë profesorin Sejjid Kutub aq sa i ka përmbushur kushtet e tilla të parapara si dhe në bazë të afërsive shkencore e kulturore që i posedonte komentuesi në fjalë.³ Ky hap kërkohet prej nesh dhe prej hulumtuesve, dhe për fat të keq, ende nuk ka gjetur diç të tillë, sepse të gjithë ata që e kritikuan dhe akuzuan, niseshin nga aspekte të ndryshme intelektuale, kulturore, fetare (besimi) që i përkisnin dhe nuk e shqyrtonin si komentues. Kjo është normale që të kenë mendime të ndryshme me mua, me ty dhe me të, sepse mësimet dhe qëndrimet nuk janë të njëjta. Ky pluralizëm është mëshirë nga Zoti dhe nga ligji i Zotit në gjithësi dhe s'ka dëm prej tij!

E kam ndarë hulumtimin tim në hyrje, në katër kapituj dhe në përfundim. Në hyrje e kam theksuar rëndësinë e hulumtimit, arsyen e zgjedhjes së kësaj teme dhe pikat që do të shqyrtohen në këtë hulumtim. Në kapitullin e parë shqyrtova gjendjen e selefrit të devotshëm me Kur'anin dhe ndikimi i profesorit Sejjid Kutub nga situata e tillë. Në kapitullin e dytë i shqyrtova disa çështje të besimit, si p.sh., koncepti i besimit në Islam - përmbajtja dhe horizontet. Në kapitullin e tretë i shqyrtova disa çështje shoqërore, si p.sh., natyra e shoqërisë jobesimtare, domethënia e hyrjes së vërtetë në Islam dhe cilësitë e shoqërisë ideale islame. Në kapitullin e katërt i shqyrtova disa çështje politike, si p.sh., sistemet njerëzore, mbështetja në të tjerë përveç Zotit, domethënia e pushtetit të Zotit etj. Pastaj e theksova përfundimin dhe rezultatet.

³ Autori i këtyre rreshtave ka një punim markant që është botuar me titullin: *"El-Mueh-helat el-ilmije veth-thekafije el-leti jexhib en jete-hal-la biha el-mufessiru fil-asril-hadith,-El-Ustadh Sejjid Kutub enmudhexhen"*, në simpoziumin e dytë ndërkombëtar: Tefsirul-Kur'an menahixh suli, në Amman, Jordan, 2008. Publikoi Xhem'ijetul-muhafidhati alel-Kur'anil-Kerim,

Kapitulli i parë

GJENDJA E GJENERATËS SË PARË ME KUR'ANIN DHE NDIKIMI I PROFESORIT NGA METODA E KËSAJ GJENERATE

1. Gjendja e gjeneratës së parë me Kur'anin

Prof. Sejjid Kutub (Zoti e mëshiroftë) mendon se Kur'ani Fisnik është shtylla, argumenti dhe udhërrëfyesi ynë në të gjitha çështjet tona të kësaj bote dhe të botës tjetër, dhe kush kërkon udhëzim e instruksion nga ndonjë besim tjetër, do të dështojë dhe Zoti do ta shkatërrojë: “Ky Kur'n është Libër i këtij da'veti, ai është shpirti ynë dhe cytësi ynë, ai është shtylla dhe ekzistenca e këtij da'veti, mbrojtësi dhe mbikëqyrësi, sqaruesi dhe komentuesi, kushtetuta dhe metoda. Ai është bazamenti i da'vetit ashtu siç mbështeten në të edhe thirrësit, duke i nxjerrë mënyrat e veprimit, metodat e lëvizjes dhe praktikumin e rrugës...”⁴

Ai (Zoti e mëshiroftë) po ashtu ia tërheq vëmendjen ummetit islamik që të mos gabojë metodologjikisht gjatë kooperimit me Kur'anin.⁵ Ummetin islamik e mbron që të mos bëjë gabime të tilla vetëm rikujtimi i gjeneratës së parë që përjetoi zbritjen e Kur'anit dhe mënyra e tyre e veprimit me këtë Libër. Në këtë kontekst, ai thotë: “Do të ekzistojë një zbrazëti e madhe në mes nesh dhe Kur'anit nëse nuk marrim parasysh faktin se Kur'ani i është shpallur popullit të gjallë që ka ekzistencë të vërtetë, që i sistemon ngjarjet reale në jetën e këtij ummeti, udhëzon jetën e vërtetë njerëzore në këtë tokë dhe zhvillon betejë të madhe brenda shpirtit të njeriut në mbarë rruzullin tokësor. Beteja e tillë formon zhvillim, ndjenja dhe reaksione..!”⁶

Sipas tij, faktori që pengon përparimin e ummetit islamik dhe përfitimin e drejtpërdrejtë nga Kur'ani Famëlartë është ai konceptual që pengon lidhjen në mes zemrës dhe Kur'anit Famëlartë. Kjo pengesë nënkupton leximet dhe tertilet e muslimanëve, të cilët e lexojnë Librin e Zotit me gjuhë, por nuk depërton në brendi të tyre dhe nuk mërzhiten për domethëniet që nxirren nga Kur'ani dhe realiteti i jetës së tyre: “Do të ekzistojë pengesë e madhe në mes zemrave tona dhe Kur'anit përderisa ne e lexojmë ose e dëgjojmë si lexim formal pa pasur ndonjë lidhje me realitetin e jetës sonë njerëzore ditore në të cilën ballafaqohet krijesa që quhet njeri dhe i tërë populli që quhen muslimanë. Ajetet e tilla janë shpallur që t'i sfidojnë epshet dhe ngjarjet e gjalla e reale, duke i udhëzuar realisht shpirtat dhe ngjarjet e tilla!”⁷

Kur'ani është mrekulli e gjallë dhe do të vazhdojë deri në Ditën e gjykimit dhe për këtë shkak duhet të marrim si shembull metodologjinë e gjeneratës së parë (selefi i devotshëm) në kooperim me Kur'anin Famëlartë. Mrekullia e Kur'anit nuk ka përfunduar me shpalljen e tij në kohën e kaluar dhe në popullin që ka kaluar, jo, por Kur'ani është mrekulli e vazhdueshme deri në Ditën e gjykimit dhe ka mundësi që t'i përballojë realitetit të hidhur njerëzor të të gjitha formave dhe mënyrave. Ai e quan këtë realitet të

⁴ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur'an*, Darush-sguruk, bot. II, 1980, Kajro, vëll. 2, f. 2 (Hyrje në tefsirin e sures Ali Imran).

⁵ Më gjerësisht rreth kësaj çështje shiko librin e prof. Kardavit: *Kejfe neteamelu meal-Kur'an*, fq. 10-175, Darush-shuruk, bot. I, 1999, Kajro.

⁶ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur'an*, vëll. 2, fq. 2-3.

⁷ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur'an*, vëll. 2, f. 4..

dhunshëm: “Xhahilijeti bashkëkohor”. Kur’ani Famëlartë është libër i gjallë, dinamik dhe vepron me jetë e lëvizje për t’i tejkaluar sfidat e ndryshme: “Mrekullia e Kur’anit vërehet nga fakti se është shpallur për t’iu drejtuar realitetit konkret në jetën konkrete të popullit të një periudhe konkrete historike, duke e shpjerë popullin në ndryshime të mëdha njerëzore historike. Megjithatë, ky (Kur’an) mund të aplikohet, të sfidojë dhe të udhëzojë edhe në kohën aktuale sikur të shpallej tash për t’i zbërthyer çështjet aktuale të shoqërisë islame që përjeton sfida të llojit të xhahilijetit, brenda shpirtit, në botën e ndjenjave, me një dinamizëm të njëjtë dhe me një realitet të njëjtë ashtu siç ishte në kohën e atëhershme”.⁸

Them se koncepti i profesorit Sejjid Kutub rreth mënyrës së lëvizjes së gjeneratës aë parë (sahabët dhe tabi’inët) në bazë të kuptimit dhe veprave që përputhen me Kur’anin Famëlartë, edhe atë duke e mësuar e praktikuar në jetën e tyre reale. Pra, e gjithë kjo ka luajtur rol elementar në kuptimin e tyre të fuqisë aktive dhe të vërtetë të Kur’anit, i cili me gjallërinë e vet e ka udhëhequr ummetin islamik. Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Nëse duam që të përfitojmë fuqi aktive nga Kur’ani, që të kuptojmë të vërtetën dinamike dhe që të mësojmë udhëzimin e çdo gjenerate të shoqërisë islame., duhet të sjellim para vetes shoqërinë e parë islame, të cilës i drejtohej Kur’ani për herë të parë, i lëvizte në jetën reale, i sistemonte situatat në Medinë dhe në tërë Gadishullin Arabik, jepte udhëzime për kundërshtarët dhe miqtë, i kontrollonte epshet e ndjenjat... Pra, Kur’ani atëherë i udhëhiqte të gjitha këto gjëra dhe i udhëzoi të zhvillojnë edhe betejën më të madhe, gjegjësisht me vetveten dhe me kundërshtarët që ishin në pusi në Medinë, në Meke e gjetiu...”⁹

Profesori Sejjid Kutub e kishte kuptuar fshehtësinë e udhëzimit të Kur’anit Famëlartë në jetën dhe veprimtarinë e gjeneratës së parë gjatë çështjeve të përditshmërisë. Kur’ani ishte mësuesi më i mirë i tyre, tërësisht i hapur për t’i edukuar, kulturuar dhe t’i përparojë gradualisht hap pas hapi ashtu siç vepron edukatori i mirë. Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Po, duhet të jetojmë me atë shoqëri të parë e t’i përjetojmë realisht në jetën e tyre reale dhe në problemet njerëzore si dhe të mendojmë rreth udhëheqjes së Kur’anit në mënyrë të drejtpërdrejtë si në çështjet ditore ashtu edhe në synimet e përgjithshme, e të shohim se si i udhëheqë Kur’ani hap pas hapi e shoqëria dalëngadalë zhvillohej e përparonte, drejtohej e ecte përpara, dobësohej e rezistonte, vuante dhe duronte, përparonte me ngadalësi e vështirësi, me durim e entuziazëm. Aty vëreheshin të gjitha karakteristikat e njeriut, të gjitha pikat e dobëta të njeriut dhe të gjitha fuqitë e njeriut...”¹⁰

Pasi që e sqaroi profesori këtë të vërtetë historike dhe mësuesin e parë metodologjik në mënyrën e kooperimit me Kur’anin Famëlartë konfirmoi me bindje të plotë se ummeti islamik, me lejen e Zotit, do ta rikthejë autoritetin dhe ndikimin e vet përmes Kur’anit Fisnik nëse kooperon me Kur’anin Famëlartë dhe me parimet e rregullat e tij. Në asnjë mënyrë nuk mund të thuhet se Kur’ani është libër i vjetër që nuk është i përshtatshëm për udhëheqjen e njerëzve ashtu siç nuk duhet thënë se dielli është i vjetër dhe se duhet të zëvendësohet me një yll tjetër. Pra, kjo do të ishte çështje qesharake!

Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Ne nëpërmes një shqyrtimi të tillë, do të shohim Kur’anin të gjallë që veproi në jetën e shoqërisë së parë islame dhe po ashtu do të veprojë edhe në jetën tonë, do ta ndjejmë se është me ne sot dhe nesër, se nuk është vetëm

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

¹⁰ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur’an*, vëll. 2, fq. 2-4.

ripërtëritje e leximeve formale dhe larg realitetit tonë, se nuk është histori që ka kaluar dhe përfunduar dhe se nuk mund të ndikojë në jetën e njerëzve. Kur'ani është e vërtetë e vazhdueshme. Gjithësia është libri i dukshëm i Zotit, ndërsa Kur'ani është libri i lexuar i Zotit, të dy janë argumente dhe fakte mbi Krijuesin e tyre... Gjithësia me sistemin e vet emde funksionon dhe lëvizë ashtu siç e ka krijuar Zoti, dielli ende lëvizë për ta kryer obligimin e vet, hëna e toka dhe të gjitha yjet e tjerë ende lëvizin... Po ashtu edhe Kur'ani luan rolin e vet te njerëzit dhe ende është po i njëjti ashtu siç është edhe njeriu po i njëjti.

Ai është ende i njëjti në të vërtetën e tij dhe në origjinën e instinktit. Ky Kur'an është fjalë e Zotit për këtë njeri për çështjet me të cilat i është drejtuar Zoti. Kjo fjalë nuk ndryshon, sepse as njeriu nuk është transferuar në ndonjë krijesë tjetër, pa marrë parasysh se sa ndryshojnë rrethanat dhe ambienti rreth tij dhe pa marrë parasysh se sa është nën ndikimin apo se sa ndikon në rrethanat dhe në ambientin e tillë... Kur'ani i flet në bazë të instinktit të tij dhe në bazë të së vërtetës së tij që nuk ndryshon dhe nuk transferohet...¹¹

2. Ndikimi i profesorit nga metodologjia e gjeneratës së parë

Nuk ka dyshim se sa herë që rilexohet Kur'ani Famëlartë, grafullojnë kuptime dhe domethënie të reja nga vetvetiu në zemrën dhe në trurin e lexuesit të sinqertë të Kur'anit, dhe këtë e kanë përjetuar shumë njerëz që punojnë sinqerisht me Kur'anin Fisnik, dhe kjo është një formë e mrekullisë dhe begative që i ka Kur'ani Famëlartë. Ai të jep shkenca, fshehtësi, urtësi e domethënie aq sa i kushton interes, kujdes, përqendrim respekt, dashuri, sinqeritet, përkushtim dhe punë, dhe pikërisht kjo kishte ndodhur edhe me profesorin Sejjid Kutub. Mendimi i profesorit në tefsir dallohej me origjinalitet, thellësi,¹² dhe e gjithë kjo ndodhi për shkak të shoqërimit të sinqertë që e kishte me Kur'anin Famëlartë gjatë leximit, kuptimit, përsiatjes, komentimit, punës dhe da'vetit: "...Kjo është një e vërtetë që përfitohet nga shoqërimi i gjatë me këtë Kur'an dhe shoqërimi i gjatë i njerëzve për t'u orvatur që ta kuptojnë dhe nga shkrimet e gjatë për një periudhë të gjatë kohore të jetës..."¹³

Profesori e kishte kuptuar se kooperimi me Kur'anin Famëlartë duhej të ishte i drejtpërdrejtë pa kurrfarë ndërmjetësimi dhe se teksti kur'anor duhet të jetë udhëzues elementar i njeriut pa pasur nevojë që t'i qasemi tekstit me idetë tona paraprake ashtu siç vepronin disa të ashtuquajtur dijetarë. Fjalët e dijetarëve dhe komentuesve të teksteve kur'anore përfaqësojnë guximin e madh për të kooperuar me Kur'anin. Nuk është qëllimi në fjalët e dijetarëve, sepse ata luanin rolin ndërmjetësues dhe si urë gjatë orvatjeve të tyre personale për t'i kuptuar dhe se nuk e mbyllnin derën e të kuptuarit të teksteve kur'anore ose profetike për njerëzit e ardhshëm nëse i plotësojnë kushtet për rezonim dhe të ixhtihadit. Këtë të vërtetë shkencore nuk duhet harruar kurrë! Profesori (Zoti e mëshiroftë) thotë: "Eca në një udhë që mund të duket e çuditshme për lexuesin modern, i cili është mësuar që gjatë studimeve të sinqerta islame t'i përdorë ajetet kur'anore vetëm si argument për konceptin që e shënon në hulumtimin e tij. Metodën që e përdori këtu është krejtësisht ndryshe. Metoda jonë orvatet që ta bëjë tekstin kur'anor si burim i të vërtetave të hulumtimit, ndërsa fjalët njerëzore i konsideron si faktorë ndihmës..."

¹¹ Po aty; Zervak Nesir, *Mekasidush-sheriatil-islamijeti fi fikril-imam Sejjid Kutub*, Darus-salam, bot. I, Kajro 2009, fq. 341-363.

¹² Kutub, Sejjid, *Mukavvimatut-tesavuril-islamij*, Darush-shuruk, bot. IV, Kajro 1998, fq. 153-154.

¹³ Po aty, f. 39.

Dëshirojmë që ky lexues të koeprojë me Kur'anin në mënyrë të drejtpërdrejtë sa herë që dëshiron të merret me ndonjë të vërtetë në çështjet e jetës dhe sa herë që dëshiron të arrijë të vërtetën...¹⁴

Prof. Sejjid Kutub konfirmon këtë rregull për t'u inspiruar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Kur'ani Famëllartë pa paragjykime apo botëkuptime paraprake. Thirrësit dhe muslimanët duhet të kuptojnë besimin islam në mënyrë të pastër e të posaçme, por jo edhe në mënyrë filozofike. Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: "Pra, metoda jonë që të frymëzohemi nga Kur'ani në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të mos i qasemi me bagazh paraprak, as nacional, as emocional e as nga kulturat që nuk i kanë nxjerrë nga vetë Kur'ani, e as t'iu kthehemi teksteve të tij dhe të frymëzohemi prej teksteve të tilla paraprake. Në fillim erdhi teksti kur'anor për të formuar botëkuptime të vërteta mbi të cilat Zoti dëshiron që njerëzit t'i formojnë konceptet dhe jetën e tyre. Ata e meritojnë këtë nga i Lartësuar dhe nga më i Madhi. Ata e mësojnë atë, i dhurojnë zemrën e mendjen e pastër pa kurrfarë mendimi të keq, sepse dëshirojnë që të formojnë koncepte të reja të pastra dhe larg xhahilijetit të kaluar apo të tashëm, duke u mbështetur vetëm në mësimin nga Zoti e jo nga hamendjet e njerëzve që nuk ndihmojnë fare. Pra, besimi duhet të formohet me metodën e besimit dhe se metoda filozofike e mbytë atë, e shuan zjarrin dhe vitalitetin e tij dhe e përkujton vetëm me një aspekt të aspekteve të shumta të qenies njerëzore".¹⁵

Në këtë mënyrë e kuptojmë interesimin e Pejgamberit a.s. për të përcaktuar besimin e mësimin dhe perceptimit gjatë formimit të parë të gjeneratës së sahabëve, gjegjësisht përqendrimin dhe mbështetjen vetëm në Librin e Zotit të pastër nga të metat që vetëm Atij t'i përkushtohen dhe vetëm Ai t'i udhëzojë në të drejtë! Ai është hidhëruar kur e ka parë Umer ibën Hattabin (r.a.), duke marrë dituri e njohuri nga një burim tjetër, gjegjësisht e ka parë një fletë të Tevratit në dorën e Umerit (r.a.), sepse ai (a.s.) dëshironte të formonte gjeneratë me zemër të pastër, me tru të pastër, me koncept të pastër, me ndjenja të pastra, me formim të sinqertë dhe të mbrojtur nga ndonjë ndikim tjetër përveç metodës hyjnore...¹⁶ Ne nuk mund të formojmë një gjeneratë me pastërti dhe vlera përpos nëse mësojmë nga gjenerata e tillë dhe bashkëpunimi i tyre me Kur'anin Famëllartë, që e përjetoj zbritjen e Kur'anit, rrethanat shoqërore e psikike. Profesori Sejjid Kutub më shumë se një herë ka potencuar se gjenerata e parë e ka lexuar Kur'anin për të mësuar urdhrin e Zotit që ka të bëjë me çështjet e tyre dhe të shoqërisë për të punuar e praktikuar e jo për ta studiuar si kulturë e zbavitje: "Metoda e mësimin për aplikim e vepër e formoi gjeneratën e parë, kurse metoda e mësimin për studim e zbavitje i nxori gjeneratat e mëpasshme".¹⁷

Ndoshta ndokush mund të kundërshtojë këtë të vërtetë historike apo këtë rregull metodologjik, por profesori Sejjid Kutub reagon me shpejtësi në sqarimin dhe anulimin e kësaj problematike metodologjike që ekzistonte në mendjen e shumë njerëzve, duke thënë: "Natyra e kësaj feje refuzon akumulimin e njohurive në trurin e frigoriferët, sepse (njohuria) në këtë fe shndërrohet në (lëvizje), sepse në të kundërtën, nuk do të ishte pjesë e kësaj feje..! Kur shpallej Kur'ani shpallej me udhëzim e parim që duhej menjëherë

¹⁴ Kutub, Sejjid, *Mukavvimatut-tesavvuril-islamij*, f. 39.

¹⁵ Kutub, Sejjid, *Hasaisut-tesavvuril-islamij ve mukavvimatuhu*, f. 13.

¹⁶ Kutub, Sejjid, *El-Mustekbelu li hadhaddin*, El-Ittihadul-islamije el-alemiye lil-munadh-dhamatu et-tul-labije, bot. I, Matbaatu Fajsal, 1988, f. 17.

¹⁷ Kutub, Sejjid, *Mealim fit-tarik*, Darul-kalem, bot. III, Bejrut 2001, f. 19.

aplikuar, do të thotë, duhej të ishin element lëvizës në shoqërinë e gjallë. Çdo tekst kur'anor nënkupton përgjigje të gjallë ndaj një situatë konkrete ose promovim i gjallë për të arritur gjendjen e kërkuar, dhe në këtë mënyrë kanë zbritur parimet e sheriatit në Medinë si lëvizje të shoqërisë islame që ishte formuar atje. Asnjë parim nuk kishte zbritur në Mekë, sepse do të ishte vetëm si njohuri, dhe për këtë shkak pritej koha e praktikimit në Medinë. Dituria për diturinë nuk është metodë e Islamit, sepse në Islam dituria është për lëvizje, shkenca për punë dhe be dhe besimi për jetë...”¹⁸

Si karakteristikë e gjeneratës së tillë ishte fakti se kur njëri prej tyre e pranonte Islamin, fillonte një periudhë të re në jetë dhe e mbyllte përfundimisht faqen e të kaluarës-xhahilijetit. Ai largohej nga e kaluara edhe nga aspekti i ndjenjave në brendi, edhe pse haptazi dukej se ai bënte tregti dhe bashkëpunonte me shoqërinë xhahilite rreth e përqark tij. Profesori e thekson këtë të vërtetë duke thënë: “Kur njeriu hynte në Islam, e shkarkonte nga vetja tërë të kaluarën e xhahilijetit. Në momentin kur hynte në Islam, ai ndjente se fillonte një periudhë të re. Kishte ndarje të plotë në mes ndjenjave të së kaluarës së muslimanit në xhahilijet dhe në mes kohës së pranimi të Islamit dhe kështu formohej ndarje e plotë nga lidhja e tyre me shoqërinë xhahilite që jetonte rreth tij dhe nga lidhjet e tij shoqërore (xhahilite), edhe pse bënte tregti me disa idhujtarë (brenda ditës). Ndarje emocionale është diçka tjetër dhe krejtësisht ndryshe nga bashkëpunimi ditor...”¹⁹

¹⁸ Kutub, Sejjid, *Mukavvimatut-tesavvuril-islamij*, pjesa e dytë, fq. 15-30; Hasaisut-tesavvuril-islamij ve mukavvimatuhu, pjesa e parë, Sejjid Kutub, f. 10.

¹⁹ Kutub, Sejjid, *Me'alim fit-tarik*, fq. 19-20.

Kapitulli i dytë

ÇËSHTJE FETARE BASHKËKOHORE NGA KËNDVËSHTRIMI I PROFESORIT SEJJID KUTUB

Islami kishte meritë të madhe në shpëtimin e njerëzve dhe në nxjerrjen e tyre nga errësirat në dritë, nga errësirat e idhujtarisë në dritën e monoteizmit të pastër, nga errësirat e të keqes në dritën e drejtësisë dhe barabarësisë, nga errësirat e legjendave dhe imitimit të verbër në dritën e intelektit dhe të argumentit të qartë dhe nga errësirat e teorive dhe dyshimeve në dritën e të vërtetave dhe aksiomave. Profesori Sejjid Kutub thotë: “Erdhi Islami në botën ku ishin të përhapura besime, koncepte, filozofi, legjenda, mendime, iluzione, tradita, simbole, situata e halle me të cilat ishte përzier e vërteta me të pavërtetën, e sakta me të pasaktën, feja me besëtytni, filozofia me legjenda. Në një situatë të tillë kaotike ndjenja njerëzore endej nëpër errësira e hamendje pa përjetuar prehje në ndonjë të vërtetë. Jeta e njeriut nën ndikimin e këtij kaosi të madh ishte zhytur në amoralitet e devijim, në dëm e nënçmim, në keqbërje e mjerim, dhe e gjithë kjo nuk i përkiste natyrës së njeriut, madje as edhe natyrës së kafshëve!”²⁰

Në pjesët e tjera të hulumtimit do të shqyrtoj disa çështje të besimit dhe çështje shoqërore, politike e etike nga këndvështrimi i profesorit Sejjid Kutub. Vetëm Zotit i mbështetem dhe vetëm Ai është Udhëzues dhe Ndhimës!

1. Koncepti i besimit në Islam - përmbajtja dhe diapazonet

Profesori Sejjid Kutub mendon se Islami është metodë e përgjithshme dhe e përkryer hyjnore që sistemon jetën e njeriut në të gjitha sferat, dhe pasi që Islami i ka të gjitha këto specifika dhe veçori, vërejmë se armiq të tij janë lodhur në aspektin psikik e intelektual me sulmet e tyre të ndryshme kundër Islamit. Ai (Zoti e mëshiroftë) i përmbledh parimet e përgjithshme islame duke thënë: “(Islami) është metodë që e përmbledh konceptin e besimit që e komenton natyrën e ekzistencës dhe e përcakton pozitën e njeriut në këtë ekzistencë ashtu siç e përcakton edhe synimin e ekzistencës njerëzore, përmbledh sisteme dhe organizime, si p.sh., sistemin etik me të gjitha specifikat, sistemin shoqëror me të gjitha parimet dhe elementet, sistemin ekonomik me filozofinë dhe problematikën, sistemin ndërkombëtar së bashku me marrëdhëniet e tij...”²¹

Këto specifika i takojnë kësaj feje e që janë universale, realiste dhe dominuese, dhe këto specifika i nxitën kryqëzatat që të sulmojnë ummetin islamik në vatanin islamik ashtu siç e nxisin edhe sionizmin ndërkombëtar sot.²²

Për ta paraqitur rëndësinë e të vërtetës së konceptit të besimit në Islam preferoj që të shtjelloj mendimet e profesorit rreth kësaj çështje përmes pikave vijuese:

I - Ndikimi i besimit islamik te njerëzit

²⁰ Kutub, Sejjid, *Hasaisut-tesavvuril-islamij ve mukavvimatuhu*, f. 19.

²¹ Po aty.

²² Po aty, f. 5; Po ashtu shiko hyrjen e librit “*Nahve muxhteme’in islamijjin*”, Prof. Sejjid Kutub, fq. 2-3.

Pasi që Islami është metodë hyjnore, atëherë vlera dhe ndikimi i kësaj metode hyjnore janë të mëdha, dhe një gjë e tillë vërehet qartë në faktin se për një kohë shumë të shkurtër ndikoi në jetën, traditat, doket dhe besimet e njerëzve, duke i shndërruar në udhëheqës e liderë të botës pasi që kishin qenë më parë në shkallën më të ulët të njerëzimit nga aspekti fetar, politik, shoqëror e etik. Ai thotë: “Për atë kohë ai pati mundësi që të formojë në realitetin e jetës një numër të madh personalitetesh ideale që kishin vlere të larta njerëzore sikur asnjëherë më parë. Ndërtimi shpirtëror, shoqëror dhe politik, i cili mbështetej në pasimin e kësaj metode unike brenda një shekulli, gjegjësisht brenda gjysmë shekulli, vazhdimisht iu kundërvijë të gjithë armiqve dhe sulmeve shtazarake që zhvilloheshin kundër tyre, më shumë se një mijë vite, madje parimet e tilla ende kanë mundësi të nxisin ringjallje të re kur i pranon gjenerata e re.”²³ Fshehtësia e këtij (suksesi) qëndron në mënyrën e kooperimit të kësaj metode me instinktin njerëzor, dhe sipas tij, funksionin drejtpërdrejtë me instinktin dhe nga burimi i tij i fshehtë inspirohet. Kjo është një depozitë e madh dhe e përhershme, dhe sa herë që takohet me këtë metodë, grafullojnë burimet e pasurisë dhe nxirren pasuritë e fshehta...”²⁴

Për këtë fshehtësi ai thotë: “Ajo është në realitet metodë instinktive që mbështetet në instinkt, dhe kjo metodë ecë shumë lehtë dhe lëmuar me jetën kur të drejtohet shpirti me nevojat instinktive, kur të fillojë fuqia të punojë e ndërtojë...”²⁵

Profesori Sejjid Kutub mendon se lulëzimi i sheriatit islamik në periudhën e kaluar historike nuk nënkupton se nuk ka mundësi që të kthehet përsëri, sepse ajo që ndodhi nuk është mrekulli që nuk përsëritet, por ishte rezultat i mundimit njerëzor brenda mundësive të tyre... Kjo që ndodh nuk ndodh me mrekulli që nuk përsëritet, por u realizua (sipas ligjit të përhershëm të Zotit) me mund njerëzor aq sa kishin mundësi, dhe kjo që ndodhi në të kaluarën tregon se një gjë e tillë mund të ndodhë përsëri.”²⁶

II - Uria speciale që mund të shuhet vetëm me besim hyjnor

Për sa i përket madhërisë së kësaj metode hyjnore dhe nevojës së njerëzve për të, profesori i krahason me një uri të posaçme që mund të zhduket vetëm nga ushqimi shpirtëror hyjnor, gjegjësisht nga besimi në Zotin e Madhëruar, dhe në këtë kontekst ai thotë: “Njeriu ndjen uri për një kohë..., dhe kjo uri (trupore) nëse plotësohet, nuk i anulonuritë e tjera (njerëzore), dhe posa të qetësohet kjo uri. lëvizin uritë tjera njerëzore, gjegjësisht uria që nuk mund ta anulojë asnjë ushqim e asnjë pije, madje asnjë kënaqësi tjetër, sepse i takon një llojit tjetër, gjegjësisht urisë për besim në një fuqi më të madhe se ajo e njerëzve, në një botë që është më e madhe se ajo e dukshmja dhe më e gjerë se jeta e kësaj bote! Kjo uri është ajo që kërkon harmonizimin në mes ndjenjave të njeriut dhe realitetit, në mes sheriatit që kontrollon ndjenjat e tij dhe sheriatit që kontrollon jetën e tij, në mes metodës së lëvizjes së tij individuale në lëvizje shoqërore... Kjo uri është për Zotin Një që mësohet nga sheriatit i zemrës dhe nga sheriatit i shoqërisë...”²⁷ Kur të pranohet njeriu musliman këtë metodë hyjnore, atëherë duhet të përkujtojë se feja e Zotit nuk mund të jetë nën udhëheqjen e tjetërkujt, por është udhëheqës dhe prijës, duhet të

²³ Kutub, Sejjid, *Hasaisut-tesavvuril-islamij ve mukavvimatuhu*, f. 28.

²⁴ Po aty, fq. 41-42.

²⁵ Po aty, fq. 28-29.

²⁶ Po aty, f. 45.

²⁷ Kutub, Sejjid, *El-Mustekbelu li hadhaddin*, f. 69; *Mukavvimatut-tesavvuril-islamij*, f. 101.

aplikohet e jo të shkojë pas të tjerëve. Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Në asnjë mënyrë nuk pranon (Feja Islame) të jetë diç tjetër përpos dominuese e fuqishme dhe ndikuese, e fortë, fisnike, prijatare e jo e udhëhequr...”²⁸ Kjo fe që ilustron në mesazhin islam nuk kundërshton shkencën, nuk i refuzon rezultatet e shkencave materiale dhe nuk është alternative e shkencës dhe qytetërimit, dhe për këtë çështje, ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Feja nuk është alternative e shkencës dhe e qytetërimit e as armik i shkencës dhe qytetërimit, por është kornizë e shkencës dhe qytetërimit, qendër e shkencës dhe qytetërimit, metodë e shkencës dhe qytetërimit brenda përkufizimit, diapazonit dhe qendrës që i sistemon të gjitha çështje e jetës”.²⁹

III - Durimi dhe qëndresa përballë masës së madhe të mëkatit

Ndokush mund të thotë se pengesa që qëndron në mes nesh dhe aplikimit të sheriatit islamik ose rikthimit të Islamit në jetën e muslimanëve është masa e madhe e mëkatit që paraqitet në xhahilijetin e bijve të këtij shekulli në rrethanat aktuale. Xhahilijeti i këtij shekulli karakterizohet me kurthe, dinakëri e kompleksitet për dallim nga xhahilijeti i parë që karakterizohej me naivitet dhe grindje. Profesori Sejjid Kutub thotë: “Xhahilijeti i parë ishte xhahilijet i injorancës, naivitetit dhe grindjes, kurse xhahilijeti bashkëkohor është xhahilijet i ditorisë, kompleksitetit dhe përdhosjes, dhe se njerëzimi sot vuan nga nënçmimi, tallja dhe përdhunimi i besimit me çdo besim dhe me çdo mendim, me çdo doktrinë ashtu siç vuan nga hipokrizia e zemrës dhe nga kurthi i dobësisë, dhe të gjitha këto janë pengesa të rrugës së da’vetit në Zot dhe të aplikimit të metodës së Zotit...”³⁰

Pra, ne jemi përpara realizimit të një projekti të madh në jetë deri në vdekje, dhe kjo kërkon durim, qëndresë e përkushtim dhe mosdorëzim para goditjeve të dhimbshme që vijnë nga mëkatarët, dhe pasi që ne kemi të drejtë, atëherë duhet të qëndrojmë fortë dhe stoikisht. Profesori na e rikujton këtë çështje me këtë këshillë: “Ne, sot, qëndrojmë para të gjitha formave dhe mënyrave të xhahilijetit që ekzistojnë rreth nesh dhe nuk duhet të dorëzohemi në asnjë mënyrë përpara asaj që është përreth nesh. Pastaj, nuk duhet të dyshojmë se ajo që ka ndodhur në rrethana të tilla duhet të ndodhë. Zemrat tona nuk duhet të dyshojnë për shkak të goditjeve që u drejtohen pionierëve të ringjalljes islame në çdo vend e as për shkak të madhësisë së parimeve mbi të cilat mbështetet qytetërimi materialist. Këtë çështje nuk e dallon masa e madhe e mëkatit, sepse nuk përfaqëson fuqinë e goditjeve kundër Islamit, por fuqia e të vërtetës dhe qëndrimi përballë goditjeve të tilla... Për shkak të perëndimit të diellit të qytetërimit perëndimor dhe bankrotimit të tij në botën e vlerave, sipas profesorit, njerëzit sot qëndrojnë përpara një dileme, jo nga rreziku i shkatërrimit që i kanoset, sepse kjo është simptomë i sëmurjes e jë vetë sëmurja, por për shkak të bankrotimit në botën e vlerave, sepse nuk ka asnjë vlerë që mund t’ia ofrojë njerëzimit...”³¹

IV - Kushtet e nevojshme për realizimin e qëndresës

²⁸ Po aty, f. 93; Po aty, f. 8, si dhe faqet 109, 107, 134, 132; *Nahve muxhtemein islamijjin*, prof. Sejjid Kutub, fq. 150-152; *Mukavvimatut-tesavvuril-islamij*, f. 146.

²⁹ Kutub, Sejjid, *El-Mustekbelu li hadhaddin*, f. 103; *Mealim fit-tarik*, f. 70.

³⁰ Kutub, Sejjid, *Hasaisut-tesavvuril-islamij*, fq. 95-96.

³¹ Kutub, Sejjid, *El-Mustekbelu li hadhaddin*, fq. 43-44.

Nëse kjo situatë është nga realiteti i xhahilijetit të sotshëm, atëherë kemi nevojë për realizimin e kushteve që të jemi të qëndrueshëm në këtë rrugë dhe përballë xhahilijetit. Cilat janë kushtet që duhet praktikuar në këtë rrugë të vërtetë e të ndërlikuar? Profesori këshillon që të pajisemi me kushtet, të cilat i kanë humbur shumica e njerëzve, gjegjësisht duhet të pajisemi vetëm me një kusht që ka të bëjë me besimin e plotë në premtimin dhe ndihmën e Zotit për robërit e Tij besimtarë: “Ndjenjat ndaj Zotit duhet të jenë të vërteta, sepse kështu përfitohet kooperim i drejtpërdrejtë me Zotin dhe besim i plotë në premtimin e Tij të prerë dhe kategorik”.³² “Nevoja e njerëzve për këtë fe është më e madhe se urrejtja e urrejtësve të kësaj feje”.³³ Nuk ka dyshim se ky koncept është i nxjerrë nga ajetet kur’anore:

“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) All-llahun, Ai ju ndihmon juve dhe u forcon këmbët tuaja” (Muhammed, 7).

“Nëse All-llahu dëshiron t’ju ndihmojë, s’ka kush që mund t’ju mposhtë, e nëse Ai iu lë pa ndihmë, atëherë kush është ai pas Tij, që do t’ju ndihmojë? Pra vetëm All-llahut le t’i mbështeten besimtarët” (Ali Imran, 160).

V - Përshkrimi i metodës dhe besimit hyjnor

Përballë këtij bankrotimi të vlerave paraqitet metoda islame si shpëtim për të gjithë njerëzit. Kjo metodë karakterizohet me vlera e veçori hyjnore që ka burimin në Zot. Kjo metodë mbështetet në shkencë, fuqi, urtësi e adhurim absolut të Zotit të Madhëruar. Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Parimi i metodës hyjnore buron nga dituria e jo nga injoranca, nga përkryerja e jo nga mangësia, nga fuqia e jo nga dobësia, nga urtësia e jo nga epshi për t’i nxjerrë njerëzit nga adhurimi i robërve (njerëzve),³⁴ në adhurimin e Zotit të vetëm e jo të të tjerëve”.³⁵

Pasi që kjo metodë karakterizohet me këto veçori dhe tipare, urtësia hyjnore ka diktuar që të dallohet nga shumë aspekte, nga metodat dhe sistemet e tjera, edhe pse kanë emra të ndryshëm. Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Dallimi në mes metodës së kësaj feje dhe metodave të tjera është se njerëzit në sistemin e jetës islame adhurojnë vetëm Një Zot., ndërsa në sistemet e tjera adhurojnë shumë zota të ndryshëm përveç All-llahut. Edhe ata janë njerëz sikur këta, robër sikur të gjithë robërit e tjerë, dhe ne i quajmë sistemet që i adhurojnë njerëzit ashtu siç i quan Zoti!, “sisteme të xhahilijetit pa marrë parasysh se sa ata dallohen në formë, ambient e kohë...”³⁶ S’ka dyshim se profesori Sejjid ka përfunduar me këtë realitet pas leximit dhe kuptimit të ajeteve kur’anore:

“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë” (Mulk, 14).

“Dhe ti vepro sipas asaj që po të shpallet nga Zoti yt; All-llahu është i njohur shumë mirë me atë që ju vepron” (El-Ahzab, 2).

“S’ka dyshim se Zoti yt është Ai që furnizon me bollëk atë që do dhe ia kufizon atij që do. Ai hollësisht e di për robërit e vet dhe i vështron” (Israë, 30).

³² Po aty.

³³ Po aty.

³⁴ Poa aty. f. 4; *Hasaisut-tesavvuril-islamij*, prof. Sejjid Kutub, f. 43; *Mukavvimatut-tesavvuril-islamij*, prof. Sejjid Kutub, f. 152.

³⁵ Kutub, Sejjid, *El-Mustekbelu li hadhaddin*, fq. 3-7.

³⁶ Po aty, f. 5.

“All-llahu është shumë bamirës për robërit e vet; Ai e begaton atë që do; Ai është i gjithëfuqishmi, ngadhënjyesi” (Shura, 19).

VI - Përkushtimi ndaj kësaj metode dikton që muslimani të jetë në fenë e Zotit

Profesori flet për përkushtimin ndaj metodës hyjnore për të vërtetuar pushtetin e Zotit dhe përkatësinë islame, sepse nëse njeriu mbështetet në ndonjë metodë, qoftë njerëzore apo hyjnore, do të veprojë sipas metodës së tillë, me dëshirë apo pa te, dhe për këtë çështje, ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Çdo metodë në jetë është (fe), dhe feja e një grupi njerëzor është ajo që dikton jetën e këtij grupi. Nëse kjo metodë që rregullon jetën e shoqërisë është nga Zoti, gjegjësisht buron nga koncepti i besimit hyjnor, atëherë kjo shoqëri do të jetë në (fenë e Zotit), e nëse është nga mbreti, udhëheqësi, fisi apo populli (gjegjësisht nëse buron nga ndonjë doktrinë, koncept apo filozofi njerëzore, atëherë kjo shoqëri do të jetë në (fenë e mbretit), ose në (fenë e udhëheqësit, ose në (fenë e fisit), ose në (fenë e popullit). Nuk është fe e Zotit, sepse nuk mbështetet në metodën e Zotit që buron nga feja e Zotit e jo nga diçka tjetër. (Feja e Zotit) jep koment të plotë e të përgjithshëm të ekzistencës dhe raportit të saj me krijuesin e Madhëruar.”³⁷

S’ka dyshim se ky koncept nxirret nga fjala e Zotit të Madhëruar:

“Ata i konsideruan "ahbarët" (priftër jehudi) të tyre, "ruhbanët" (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos All-llahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj All-llahut një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë” (Teube, 31).

VII - S’ka ndarje të fesë nga kjo botë në Islam

Një nga karakteristikat dhe veçoritë më të rëndësishme të kësaj feje hyjnore q i ka zbritur Pejgamberit tonë, Muhammedit a.s., është karakteristika e universalizmit, sepse nuk mund të paramendohet në asnjë mënyrë ndarja e saj nga organizimi i të gjitha çështjeve tona në jetën e kësaj bote, gjegjësisht çështjet politike, ekonomike, shoqërore e etike. pra, kjo fe dhe ky sistem hyjnor nuk përqendrohen vetëm në rrethin e ngushtë të adhurimit. Për këtë çështje, profesori (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Nuk do të kishte kuptim për fenë sikur të largohej nga sistemimi i jetës reale me koncepte, gjykime, ligje dhe udhëzime të posaçme...”³⁸ Nuk është natyrë e (fesë) që të ndahet nga bota dhe nuk është natyrë e metodës hyjnore që të përkufizohet vetëm brenda simboleve instinktive, etike- edukative dhe adhuruere ose vetëm në suaza të ndonjë pjese të ngushtë të jetës njerëzore që quhet: “e drejtë civile”...³⁹

“Nuk është natyrë e (fesë) që të caktojë rrugë për në ahiret pa kaluar nëpër jetën e dynjasë, sepse rruga e tillë do të ishte përfitimi i xhennetit të ahiretit pa punuar në tokë, dhe për njerëzit kjo do të ishte e kundërta e asaj që nënkupton metoda e Zotit...”⁴⁰ profesori e quan këtë ndarje të fesë nga kjo botë: “ndarja intrigante” që ka lindur në

³⁷ Kutub, Sejjid, *El-Mustekbelu li hadhaddin*, f. 18.

³⁸ Po aty, f. 25.

³⁹ Kutub, Sejjid, *El-Mustekbelu li hadhaddin*, f. 27.

⁴⁰ Po aty, f. 18.

rrethana evropiane dhe që është specifike për kishën evropiane,⁴¹ dhe s'ka kurrfarë raporti me Islamin dhe me historinë e muslimanëve. Kjo ndarje shkaktoi shpëputjen e fesë nga shteti. Ai (Zoti e mëshiroftë) thotë:

*“Ndarja e tillë intrigante ndodhi në rrethana intriguese dhe rrënjët e saj destruktive ishin në Evropë e më pas u përhap në mbarë rruzullin tokësor kur filluan konceptet, sistemet dhe pikëpamjet perëndimore të dominojnë në mbarë botën, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Kështu u nda jeta e krijesave nga metoda e Krijuesit për të ecur në këtë rrugë të mjerë dhe të përfundojë në këtë përfundim të kotë, t'i bëjë njerëzit të vuajnë, duke shijuar mjerimin e njëri-tjetrit pa e ditur rrugën e shpëtimit. Pra, të tillët janë të hutuar...”*⁴²

Nëse di diçka rreth madhërisë së metodës së Islamit, atëherë do të kuptosh se si i përfiton zemrat e kundërshtarëve të Islamit në çdo kohë dhe në çdo vend, në çdo periudhë dhe në çdo hapësirë. Profesori thotë: “Për shkak të këtyre karakteristikave të Islamit e luftojnë kundërshtarët në mënyrë të ashpër, sepse iu pengon rrugën dhe parandalon realizimin e shpresave të tyre kolonialiste okupuese, si dhe i ndalon që të bëjnë dëm dhe të luajnë rolin hyjnor në tokë ashtu siç dëshirojnë! Për këtë shkak ata ndërmarrin sulme kategorike shkatërrimtare dhe përhapin propaganda të njollosjes, intrigës e nënçmimit...”⁴³

2. Lidhja e bashkimit dhe unitetit

Në komentimin e Sejjid Kutubit për ajetin paraprak, të sures Enfal, flitet për mënyrat konstruktive të bashkimit e unitetit në mes muslimanëve, dhe të gjitha këto mënyra mbështeten në lidhjen e besimit islamik e jo në lidhje të tjera për të lartësuar humanitetin e njeriut ndaj aspekteve të tjera. Ai thotë: “Dhe pastaj Islami (ai e mbështet mendimin islamik në këtë parim dhe në këtë metodë, si dhe në bazë të këtij parimi ai flet për unitetin organik dinamik në bazë të lidhjes së besimit) ka për qëllim paraqitjen e “humanitetit të njeriut”, përforcimin, mundësinë dhe lartësimin e këtij aspekti në krahasim me aspektet e tjera të qenies njerëzore. Ai ecë në këtë metodologji në çdo parim, në mësim, ligje e principe...”⁴⁴

Pra, filozofia e Islamit përqendrohet në nevojën e bashkimit dhe unitetit në bazë të lidhjes së besimit, ecila e shfaq, e forcon, e mundëson dhe e lartëson aspektin human të njeriut ndaj aspekteve tjera. Ai kishte të drejtë kur thoshte se lidhja e besimit dhe fesë është lidhje origjinale instiktive fetare, të cilën e ka ngulitur në instiktin e njerëzve para se t'i krijojë, dhe nuk ka ndryshim në sistemin e Zotit. Të gjithë njerëzit pranojnë monoteizmin, hyjninë dhe pushtetin e Zotit para se të krijohen dhe të gjithë janë të pastër që nga amshueshmëria, por djajtë e njerëzve i largojnë nga kjo rrugë përmes sistemeve, ligjeve e traditave të tyre. Zoti i Madhëruar thotë: “*Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuar të vetes së tyre (duke u thënë): "A nuk jam Zoti juaj?" Ata thanë: "Po, dëshmuam!". Të mos thoni në ditën e kiametit: "Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur"* (A'rafë, 172).

⁴¹ Për detajet rreth ndarjes së kishës së krishtere dhe hebraike shiko veprën e Jusuf, Muhamed Hasan: “*Es-Safhatus-seuda lil-kitabil mukaddes*”, f.30-50

⁴² Kutub, Sejjid, *El-Mustakbelu li hadhaddin*, fq. 18-19.

⁴³ Po aty, fq. 58-59.

⁴⁴ Po aty, vëll. 3, f. 1559.

Në një hadith kudsij thuhet e njëjta gjë me fjalë të përafërta. Imam Ahmedi transmeton në Musnedin e tij nga Ajjadi se Pejgamberi a.s., një ditë në hutbe, tha fjalët e All-llahut: “Dhe Unë i krijova robërit e mi të pastër, por djajtë i larguan nga feja e tyre, ua ndaluan atë që ua lejova dhe i urdhëruan që të më shoqërojnë mua atë që nuk i kam dhënë pushtet”.⁴⁵

Pastaj profesori Sejjid Kutub flet në mënyrë kategorike rreth kësaj çështje që ka të bëjë me lidhjen e besimit, dhe se të gjitha format e tjera të unitetit para kësaj lidhjeje janë të dobëta. Ai thotë: “Kjo lidhje është rrjedha , e jo gjuha, koka, lloji, ngjyra, interesi e as jeta e përbashkët në tokë, sepse lidhjet e tjera janë të njëjta si të njerëzve ashtu edhe të kafshëve... Besimi komenton ekzistencën e njeriut dhe të kësaj gjithësie në mënyrë të përgjithshme ashtu siç komenton edhe fillimin e ekzistencës, të gjithësisë rreth tij, rrugën e tij dhe të gjithësisë, duke e ngritur më lartë se materia e që dallon në cilësi nga krijesat e tjera, e konfirmon formën më të lartë të njerëzisë së tij, që e dallon njëkohësisht edhe nga të gjitha krijesat e tjera.

Lidhjet e tilla (lidhjet e besimit, konceptit, idesë dhe metodës) janë lidhje të lira të cilat i zgjedhë njeriu me dëshirë të plotë dhe vetëdije të pastër, kurse lidhjet fisnore janë të obliguara, sepse nuk i ka zgjedhur vetë. Askush nuk mund t’ia ndryshojë rrjedhën, as llojin e as ngjyrën me të cilën është lindur, sepse këto gjëra janë caktuar në jetën e tij para se të lindë pa ndonjë zgjedhje personale. Po ashtu është vështirë të ndryshohen edhe lidhjet e tjera që kanë të bëjnë me tokën ku ka lindur, me gjuhën që flet, sepse aty nuk ka vend për dëshirën e lirë dhe për këtë shkak Islami nuk i konsideron si lidhje për unitetin njerëzor. Besimi, koncepti, ideja dhe metoda janë gjithmonë të hapura për njeriun që të zgjedhë dhe në çdo moment mund t’i zgjedhë, duke u përcaktuar për një përkatësi me liri të plotë pa e kufizuar gjuha, ngjyra, lloji, rrjedha apo vendlindja.

Pastaj profesori Sejjid Kutubi i thekson rezultatet e spikatura të kësaj metode hyjnore që tregon madhërinë, gjerësinë dhe mëshirën e Islamit. Islami cakton besimin si element të bashkimit të popujve të ndryshëm dhe se parimi i besimit është i vetmi që mbizotëron në të gjithë popujt njerëzor të të gjitha kombeve, elitave dhe se vetëm në këtë mënyrë do të tejkalohen përçarjet nacionale, klasore e pushtetare, duke shënuar shembuj konkret historik nga popujt dhe qytetërimet e tjera. Ai thotë: “Nga rezultatet e rralla dhe të spikatura të kësaj metode ishte fakti se shoqëria islame u bë shoqëri e hapur për të gjithë njerëzit, popujt, kombet, ngjyrat e gjuhët pa pasur asnjë pengesë naive shtazarake. Karakteristikat e tjera të njerëzve shkrihen në këtë kompleks, duke formuar përbërje organike brenda një kohe relativisht shumë të shkurtër. Ky unitet i çuditshëm, i ndërlidhur dhe koherent dhuroi një qytetërim të mrekullueshëm e të madh që e bënte fuqinë njerëzore të bashkuar...

Në shoqërinë islame u bashkuan arabi, persiani, siriani, egjiptiani, marokeni, turku, indiani, romaku, greku, indoneziani, afrikani, etj. Aty po ashtu u bashkuan edhe karakteristikat e tyre që të shkrihen, të ndikojnë dhe të solidarizohen në formimin e shoqërisë islame dhe qytetërimit islam. Ky qytetërim i madh nuk ka qenë asnjëherë “arab” por vetëm “islamik”, dhe asnjëherë nuk ka qenë “nacional”, por i përkiste “besimit”. Të gjithë ishin të barabartë, të afërt dhe të kthyer në një drejtim. Aty paraqitet “humaniteti” i tyre pa asnjë pengesë dhe një bashkim i tillë nuk ka ndodhur asnjëherë në histori. Bashkimi më i njohur në historinë e kaluar ka qenë tubimi romak, sepse

⁴⁵ *Musnedi i Imam Ahmedit*, tahkik Shejh Shuajb Arnaut ve Adil Murshid, Muessesetur-risaleti, bot. I, 2001, nr. 523; *Sahihi i Imam Muslimit me komentimet e Neveviut*, Darul-kalem, bot. II, 2003, nr.590

ngërthente në vete popuj të ndryshëm, gjuhë të llojlojshme dhe toka të ndryshme, por të gjithë ishin të bashkuar me lidhjen e “njerëzisë” e jo me ndonjë vlerë të lartë siç është besimi. Edhe në historinë më të re ndodhën disa tubime të tjera, si p.sh., unioni i perandorisë britanike, por si rrjedhojë e bashkimit romak. Bashkimi i tyre ishte nacional dhe eksploatues, sepse u formua në parimin e dominimit nacional anglez dhe shfrytëzimit të vendeve që ishin nën koloninë e perandorisë... Të tilla ishin të gjitha perandoritë evropiane, si p.sh., perandoria spanjolle, portugeze një kohë edhe perandoria franceze.⁴⁶ Komunizmi tentoi të formojë një shoqëri tjetër që i tejkalonte barrierat e kombit, tokës, gjuhës dhe ngjyrës, jo në bazë të parimit të “njerëzimit” por në atë të parimit “klasor”. Kjo ishte një formë tjetër e bashkimit të vjetër romak, sepse “kërkesat elementare” të njeriut janë “ushqimi, banimi dhe marrëdhëniet gjinore”. Këto janë nevoja shtazarake, dhe sipas kësaj historia e njeriut është histori e kërkimit të ushqimit?! Ata e mënjanojnë fenë nga çdo sferë, sepse mbështeten në komb, tokë ose klasë. Pra, këto janë vërtetë armiq të njeriut, sepse dëshirojnë të rikthejnë njeriun në bashkimin e hordhive shtazarake të mëpashme, pasi që e ka ngritur njeriun në pozitë të respektuar dhe e ka bërë që të bashkohet në atë mënyrë që i takon tubimit të njerëzve.

Është për t’u habitur nga fakti se bashkimi në emër të karakteristikave të larta të njeriut quhet stagnim dhe regres, ndërsa bashkimi në emër të karakteristikave të shtazës quhet progres, përparim dhe ngritje.

Por Zoti ngadhënjën në çështjen e Tij dhe kështu, këta elemente shtazarake xhahilite janë zhdukur nga jeta e njerëzve dhe me siguri do të ndodhë ajo që e dëshiron Zoti”.⁴⁷

⁴⁶ Perandoria sllave, ruse dhe serbe të ne në Gadishullin Ballkanik - Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbia prej xhek. XVII e deri në shek. XX (Lufta e fundit në Bosnjë e Hercegovinë gjatë viteve 1990=1995 dhe në Kosovë gjatë viteve 1997-1999).

⁴⁷ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur’an*, vëll. 3, fq. 1559-1560.

Kapitulli i tretë

ÇËSHTJET SHOQËRORE BASHKËKOHORE NGA KËNDVËSHTRIMI I PROFESORIT

1. Natyra e shoqërisë që nuk beson dhe mënyra e sfidimit të saj

Njohja e tipareve dhe veçorive të shoqërisë që nuk është islame ka rëndësi të madhe për të mos rënë në kthetrat dhe në prehjen e intrigave të armiqve të Islamit dhe ithtarëve të Mëshiruesit. Ata kanë një trup, një formë dhe një cak, dhe për këtë çështje Zoti i Madhëruar thotë: *“Ata nuk mund të mbrojnë ty për asgjë tek All-llahu. Zullumqarët janë miq të njëri-tjetrit, kurse All-llahu është mbrojtës i besimtarëve të devotshëm”* (Xhathije, 19).

“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët...” (Maide, 51).

Shoqëria jobesimtare është një dhe ka unitet organik, dhe në bazë të kësaj përbërjeje organike, shoqëria e tillë lëvizë, mbron dhe vepron. Nëse muslimanët dëshirojnë që t’u kundërvihen të tillëve, atëherë patjetër të veprojnë në të njëjtën metodë, në të njëjtat tipare dhe në të njëjtat veçori, projekte të tyre. Kur të kuptojnë muslimanët këtë të vërtetë dhe nëse orvaten në këtë mënyrë të realizojnë pushtetin e muslimanëve, atëherë do të shpëtojnë nga armiqtë e tyre dhe rezultati do të jetë i bekuar, ose në të kundërtën, do të ketë firne e fesad të madh në tokë. Në komentimin e ajetit kur’anor: *“Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmuje e madhe në tokë”* (Enfalë, 73), profesori (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Gjërat e kanë natyrën ashtu siç theksova më parë. Shoqëria xhahilite nuk lëvizë si individë, por lëvizë si qenie organike, ndihmojnë njëri-tjetrin dhe mbrojnë qenien e vet me këtë natyrë të tillë. Ata solidarizohen me njëri-tjetrin në natyrë e vendime dhe Islami mund t’u kundërvihet si një shoqëri tjetër që ka karakteristikat e veta, por në një shkallë më të thellë, më të fuqishme dhe më të fortë. Nëse kjo shoqëri nuk është e bashkuar, do të mbizotërojë rrëmuja e shoqërisë xhahilite dhe në këtë mënyrë fitneja do të përhapet në tokë dhe xhahilijeti do ta dominojë Islamin, si dhe do të përhapet amoraliteti në tokë për shkak të sulmit të xhahilijetit ndaj Islamit, hyjnia njerëzore do të dominojë mbi hyjninë e Zotit dhe njerëzit do të adhurojnë diçka tjetër, gjegjësisht robërit do të adhurojnë robërit, dhe kjo është e keqja më e madhe: *“E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmuje e madhe në tokë”* (Enfalë, 73). Dhe në një situatë të tillë, vërejtjet nuk do të jenë vërejtje e as ndëshkimi, ndëshkim. Muslimanët që nuk mbështeten në unitetin organik dinamik me pushtet dhe udhëheqësi të përbashkët, do të bartin përgjegjësinë para Zotit për shkak të fitnes dhe amoralitetit në kohë. Kjo fe është metodë e jetës, dhe do të mund të ketë funksion real vetëm nëse ka bashkim dinamik. Ekzistenca e formës së besimit do të ekzistojë nëse funksionon si lëvizje reale. Ata që janë besimtarë të vërtetë do të jenë të falur dhe do të kenë furnizim fisnik. Këtu fjala “furnizim” nënkupton orvatjen, financimin, ndihmën dhe të gjitha obligimet, dhe bmi të gjitha mëshirën që është nga furnizimi fisnik, madje është furnizimi më i respektuar...”⁴⁸

2. Hyrja në Islam është e vërtetë dhe cilësitë e shoqërisë islame ideale

⁴⁸ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur’an*, vëll. 3, f. 1452.

Në tefsirin e profesorit në lidhje me ajetin kur'anor: *“O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishëm (përqafojeni fenë islame në tërësi), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik juaj i hapët”* (Bekare, 208), thuhet se Zoti i tregon të gjitha dimensionet, faktet e besimit dhe gjurmët pozitive të së vërtetës së hyrjes në Islam dhe dorëzimit përpara të vërtetës së Zotit të Madhëruar, të metodës së Tij të shëndoshë dhe të ndikimit të saj nga aspekti biheviarist, etik dhe fetar, dhe në krahasim me disa shtete perëndimore, ai (Zoti e mëshiroftë) thotë:

“Ky është da’veti i besimtarit në emër të besimit, dhe besimi i tillë i bën të dalluar e të veçantë dhe me Zotin arrijnë atje ku duhet, gjegjësisht të hyjnë të gjithë besimtarët në një unitet të përbashkët. Koncepti i parë i këtij da’veti është që t’i dorëzohen besimtarët tërësisht Zotit, me qenie e me trup në të gjitha çështjet e tyre të mëdha e të vogla. Dorëzimi i tillë nënkupton respektim, qetësi, bindje dhe pëlqim. Ky dorëzim nënkupton pranimin e faktit se një dorë i udhëheq në të mirë, të drejtë dhe të jenë të qetë në rrugë e kahe, , në këtë botë dhe në botën tjetër. Ky da’vet u drejtohet në çdo moment atyre që besojnë që të jenë të sigurtë dhe të përkushtuar si dhe të jenë me mendime e ndjenja me atë që dëshiron Zoti për ta dhe të jenë të drejtuar kah ajo që i udhëzon Pejgamberi dhe feja e tyre, pa hezitim, huti e hamendje. kur të përgjigjet muslimani në këtë mënyrë, do të hyjë në botën që është tërësisht në qetësi e në paqe, në botën e qetësisë dhe trankuilitetit, i qetë dhe i sigurt, pa vështirësi e mbresa, pa devijime e humbje, i qetë në shpirt dhe në ndjenja, i qetë në intelekt e logjikë, i qetë me njerëzit dhe ekzistenca, me të gjitha qeniet, i qetë në çdo aspekt të jetës dhe shoqërisë, i qetë në tokë dhe në qiell. Ky besim është i bukur krahas asaj që është fisnik. Ky besim ka shpirt të qetësisë dhe dominon mbi të gjitha ekzistenca, siguron paqe e rehati, dashuri e paqe. Besimi në Ahiret luan rol të rëndësishëm në përhapjen e qetësisë në shpirtin e besimtarit dhe në botën e tij si dhe mohon trazirat, depresionin e ngarkesat psikike. Llogaria përfundimtare nuk do të jetë në këtë botë dhe as shpërblimi nuk do të jetë në këtë botë, por në atë botë dhe se drejtësia absolute është e garantuar në atë llogari. Atje nuk ka amoralitet dhe vepra të këqija, as mashtrim e intriga. Ai nuk duhet të bëjë dëme dhe të këqija e as të përdorë mjete e vegla të fëlliqura. Ai nuk duhet të pengojë rrugën dhe të merret me çështje të vështira. Ndjenja e besimtarit se ecë sipas caktimit të Zotit dhe nënshtrimi i tij i plotë ndaj Zotit për të realizuar dëshirën e Zotit formojnë në shpirtin e tij qetësi, rehati dhe stabilitet, e bëjnë të ecë i qetë dhe pa brenga para vështirësive dhe problemeve. Obligimet që ia caktoi Islami muslimanit përputhen plotësisht me instinktin pa kurrfarë ngarkese për natyrën dhe psikikën e njeriut si dhe nuk pengon asnjë aspekt të potencialit të tij për punë, ndërtim e zhvillim...”

Shpirti i paqes vërehet qartë në një shoqëri që formohet nga kjo metodë hyjnore dhe brenda sistemit që grafallon nga ky besim i bukur dhe fisnik. Pra, aty garantohet njeriu, autoriteti dhe pasuria... Kjo shoqëri është e mbushur me solidaritet, dashuri, bashkëpunim dhe marrëdhënie të mira. Islami formon një shoqëri me formën më të bukur që mund të ekzistojë, dhe se shoqëria e tillë është më e mira në krahasim me shoqëritë e tjera që i formon xhahilijeti, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, pa marrë parasysh se në çfarë forme apo koncepti pikëzon.

Kjo shoqëri ka vetëm një lidhje, gjegjësisht lidhjen e besimit, sepse aty shkrihen kombet, fiset, shtetet, gjuhët dhe ngjyrat si dhe të gjitha lidhjet e tjera që nuk kanë lidhje me esencën e njeriut. Për këtë shoqëri Zoti i Madhëruar thotë: *“Vërtetë besimtarët janë*

vëllezër!” Për këtë shoqëri Pejgamberi a.s. thotë: “Shembulli i besimtarëve në dashurinë, kooperimin dhe solidarizimin e ndërsjellë është sikur trupi ose një pjesë e tij që ankohet, të gjitha pjesët e tjera të trupit janë vigjilente dhe të shqetësuara”.

Edukata e kësaj shoqërie është kjo: “Nëse përshëndeteni, përshëndetuni në mënyrë më të bukur...”, “Mos ecë në tokë kryelartë...”, “Përgjigju në formën më të bukur...”, “O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke e nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë” (Huxhurat, 11). “Gjaku, autoriteti dhe pasuria e muslimanit janë të ndaluara për muslimanin (të keqpërdoren nga ana e muslimanit kundër muslimanit).

Në këtë shoqëri të pastër nuk ka amoralitet, as cytje, as fitne, as zbukurim publik, nuk shikohen për të keq dhe epshet nuk shkojnë në haram ashtu siç ndodhë në shoqërinë xhahillite, në të kaluarën e në të tashmen... Këtë shoqëri e udhëzojnë shumë rregulla hyjnore. Zoti i Madhëruar thotë: “Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënimi i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk i dini” (Nurë, 19).

“Laviren dhe lavirin t'i rrihni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që besoni All-llahut dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh” (Nurë, 2).

“Thuju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata” (Nurë, 30).

“Thuju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre..., dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet...” (Nurë, 31).

Kjo shoqëri ofron siguri për gruan nga burri dhe për burrin nga gruaja si dhe mbron autoritetin dhe nderin e pasardhësve, siguron zemrat dhe nervat e njerëzve duke i çrrënjësuar fitnet dhe në të njëjtën kohë i mbron zemrat nga gjërat e ndaluara. Shoqëria islame është e pastër nga tradhtitë e ndërsjella, nga epshet e fshehura, nga sëmundjet shpirtërore dhe nga shqetësimet nervore, sepse ofron siguri e qetësi. Në këtë shoqëri mbizotëron paqja, pastërtia dhe siguria!

Dhe në fund, kjo shoqëri siguron për njeriun e aftë punë e furnizim, ndërsa për të paaftin siguri e jetesë fisnike. Për njeriun e drejtë ofron bashkëshorte të devotshme. Në këtë shoqëri, nëse ndokush vdes nga uria, secili do të japë përgjegjësi përkatëse, madje disa fukaha të Islamit obligojnë pagesën e kompensimit. Në këtë shoqëri garantohen liria, pasuria, nderi e autoriteti me ligje të sheriatit që janë udhëzime hyjnore. Aty nuk merret parasysh hamendja, nuk spiunohet askush e as nuk derdhet gjaku i askujt kot, sepse ekziston ligji. Aty ka ligje që mbrojnë nga humbja apo vjedhja e pasurisë. Kjo shoqëri mbështetet në këshilla, konsultime e kooperim ashtu siç mbështetet në barabarësi e drejtësi për çdokënd. Aty veprohet sipas ligjeve të sheriatit të Zotit e jo sipas dëshirës së udhëheqësit, i cili nuk është i paprekur...

Të gjitha këto ishin disa nocione për të cilët flet ajeti dhe i thërret të gjithë që të hyjnë aty e të shpëtojnë që të gjithë, sepse veten e tyre do t'ia nënshtrojnë Zotit. Aty nuk

ka tirani ndaj ndokujt, sepse çdo gjë vepron sipas urdhrave të Zotit të Madhëruar. Askush nuk mund të kuptojë paqen e vërtetë nëse nuk di si t'i largojë vështirësitë dhe shqetësimet shpirtërore që mund të qetësohen vetëm me besim. Në shoqërinë që nuk e njohin Islamin apo e kanë njohur, por më pas janë kthyer në xhahilijet për arsye të ndryshme, do të vëresh se, edhe pse ekziston pasuri e bollshme dhe përparim qytetëruar, aty dominon mjerimi dhe pesimizmi.

Mjafton të theksojmë vetëm një ndodhi në Suedi që konsiderohet si shteti më i shkolluar evropian, ku një individ fiton një shumë të madhe parash nga buxheti kombëtar, ku secili ka sigurim shëndetësor, ku fiton i sëmurë ndihmë financiare dhe shërim falas në spitale, ku arsimimi i të gjitha niveleve është pa pagesë, duke iu ndihmuar në veshje e libra nxënësve të dalluar, ku shteti iu ndihmon bashkëshortëve 300 funta për veshjen e shtëpisë, ku ka pasuri të çuditshme qytetëruar, por çka ndodh? Çka ka pas kësaj pasurie të madhe materiale e qytetëruar dhe pas kësaj zbrazëtire nga besimi në Zot? Ky popull është në rrezik që të zhduket dhe rrjedha është në rënie e sipër për shkak të përzënies kaotike. Në çdo të gjashtën martese ka ndarje për shkak të amoralitetit, fitneve dhe lirisë në përzënie. Gjenerata e re është devijuar dhe jeton me lëndë narkotike e alkoolike për të gjetur qetësi shpirtërore, që është i zbrazët nga besimi. Sëmundjet psikike dhe diagnozat e jashtëzakonshme janë me dhjetëra mijëra raste, duke ndihmuar në shpirt, në emocione e në nerva dhe pastaj vijon vetëvrasja. Kështu është situata edhe në Amerikë! Situata është më kritike edhe në Rusi! Kështu ndihen të gjitha zemrat e zbrazëta e që janë larg qetësisë së besimit. Kur thërret Zoti që të gjithë të besojnë e të hyjnë në qetësi, ua tërheq vërejtjen që të tërhiqen nga hapat e djallit. Në këtë rast ekzistojnë vetëm dy drejtime: ose hyrja e të gjithëve në shpëtim ose ndjekja e hapave të djallit, pra ose udhëzimi ose humbja, ose Islami ose xhahilijeti, ose rruga e shpëtimit ose rruga e djallit, ose udhëzimi i Zotit ose devijimi i djallit. Pra, në një situatë të tillë muslimani duhet të dijë pozitën e vet dhe të mos hutohet në mes rrugëve dhe drejtimeve të ndryshme. Nuk ka rrugë të mesme, as pa përcaktim e as përgjysmim, por vetëm e drejta ose e padrejta, udhëzimi ose humbja, Islami ose xhahilijeti, metoda e Zotit ose devijimi i djallit...⁴⁹

⁴⁹ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur'an*, vëll. 1, f. 211; Shiko po ashtu edhe një libër të njëjtë të titullohet: "Amerika mine-dahil bi mindhari Sejjid Kutub, dr. Salah Abdulfettah El-Halidij, Darul-kalem, Damask, bot. VIII, 2002, fq. 161-175.

ÇËSHTJE POLITIKE NGA KËNDVËSHTRIMI I PROFESORIT

1. Sistemet njerëzore dhe mbështetja në zota tjerë përveç All-llahut

Në komentimin e profesorit Sejjid Kutub në lidhje me ajetin kur'anor: "*Thuaju (o i dërguar): 'O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut'!*" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "*Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!*" (Ali Imran, 64), bisedohet për çështjen e njerëzve ligjvënës, për mbështetjen e njerëzve në zota tjerë përveç All-llahut dhe për marrjen e ligjeve dhe dispozitave prej tyre. Sipas profesorit, njerëzit e tillë i bëjnë shok Zotit, sepse i lejojnë njerëzit të veprojnë atë që ua ka ndaluar Zoti. Pa marrë parasysh se a e pranojnë njerëzit këtë të vërtetë ose jo, pranimi me gojë ose me zemër është pranim negativ. Profesori (Zoti e mëshiroftë) thotë: "E vërteta e kësaj çështje ka të bëjë pikësepari me monoteizmin hyjnor dhe se nuk ka adhurim tjetër përveç All-llahut. Vetëm All-llahut duhet nënshtruar! Vetëm prej Zotit duhet mësuar dhe vetëm Atij duhet t'i takojë adhurimi! Vetëm Atij duhet t'i nënshtrohemi dhe vetëm prej Tij duhet të mësojmë.., të mësojmë në ligje, të mësojmë në vlera e parime, mësim në sjellje e moral, mësim për çdo gjë që ka të bëjë me sistemin e jetës njerëzore.., sepse në të kundërtën, do të ishte idhujtari ose pabesim pa marrë parasysh se a e pranojnë zemrat me një pranim negativ e që nuk ndikon në jetën e përgjithshme të njerëzve... Karakteristikat më të dukshme hyjnore që krahasohen me ato njerëzore janë: adhurimi i robërve (njerëzve). Kush tenton të deklarojë ndonjë karakteristikë të tillë, atëherë i shfaq karakteristikat hyjnore dhe përcakton zot tjetër për njerëzit përveç All-llahut. Kjo mënyrë do të ndikojë në përhapjen e amoralitetit në kohë ashtu siç ndodh kur ka shumë zota në tokë. Kur njerëzit i adhurojnë njerëzit dhe kur ndonjë rob (njeri) mendon se njerëzit duhet ta adhurojnë si zot, se ka të drejtë në ligje, vlera e drejtësi, atëherë e gjithë kjo është pretendim hyjnor, edhe pse nuk e shprehë haptazi ashtu siç shprehej faraoni: "*Unë jam zoti juaj më i lartë!*" (Naziat, 24). Kjo deklaratë është idhujtari në Zot ose kufër,

Ky da'vet thërret në një fjalë të përbashkët, duke mos i dhënë epërsi askujt dhe duke mos adhuruar njëri-tjetrin. Këtë da'vet e refuzon vetëm kokëforti dhe mëkatari, sepse nuk e duan të vërtetën e fuqishme. Ky da'vet thërret në adhurimin e Zotit, duke mos i shoqëruar asgjë, as njeri e as guralec. Ky da'vet nuk lejon që njerëzit të marrin zota tjerë përveç All-llahut, as ndonjë peygamber e as ndonjë resul, sepse të gjithë janë robër të Zotit, por Zoti i ka zgjedhur që të transmetojnë mesazhin e Tij, e jo për ta shoqëruar në hyjni e adhurim: "Nëse refuzojnë, thojuni: "Dëshmoni se ne jemi muslimanë". Ky takim është në mes muslimanëve dhe atyre që marrin zota të tjerë përveç All-llahut dhe deklaratë e qartë se cilët janë muslimanë. Muslimanë janë ata të cilët e adhurojnë vetëm Zotin, i bëjnë vetëm Zotit ibadet dhe nuk e marrin njëri-tjetrin për zota përveç All-llahut. Njerëzit në të gjitha sistemet tokësore marrin zota të tjerë përveç All-llahut. Kjo ndodh në tokën e demokracisë dhe të diktaturës. Adhurimi i tyre nuk bëhet për hir të Zotit. Vetëm në sistemin islamik çlirohet njeriu nga kjo robëri dhe bëhet i lirë, gjegjësisht i lirë në koncepte, sisteme, metoda, ligje, dispozita, vlera e parime të marra vetëm nga Zoti, dhe të

tillë konsiderohen të gjithë njerëzit. Të gjithë trajtohen në një mënyrë, kanë vetëm një Zotëri dhe nuk adhurojnë zota të tjerë përveç All-llahut. Islami, sipas këtij koncepti, është fe e Zotit dhe me këtë janë shpallur të gjithë pejgamberët e Zotit. Kush e refuzon, nuk është musliman me dëshmi të Zotit. Këta do të shpëtojnë dhe të humburit do të dështojnë!”⁵⁰

2. Pushteti i Zotit

Profesori flet gjerë e gjatë rreth çështjes së pushtetit të Zotit në shumë faqe të tefsirit të tij, sepse kjo çështje është një nga çështjet më të rëndësishme islame. Ai habitet nga disa thirrës bashkëkohorë të Islamit, të cilët nuk i kanë kuptuar domethëniet dhe perimetrat e kësaj çështje. Thirrësit e tillë “ambiciozë” për fat të keq nuk e kanë kuptuar lidhjen në mes besimit dhe sheriatit islamik, sepse një ndarje e tillë ka ndodhur për shkak të tentimeve të njëpasnjëshme të armiqve të Islamit, të cilët ishin ushtarë të përgatitur për prishje e shkatërrim gjatë shekujve. “Ambiciozët” dhe ithtarët e tillë të Islamit nuk e kanë lexuar Kur’anin ashtu siç duhet dhe nuk i kanë lexuar tekstet në përgjithësi kur i kanë gjykuar idhujtarët për shirk e kufër dhe dalje nga shoqëria, duke mos e gjykuar atë që mbështetet në djallin për kufër e shirk! Pasha jetën time, kjo është vërtetë një çështje shumë e çuditshme, sepse injorojnë fjalën e Zotit të Madhëruar: “*Nëse ju nënshtroheni atyre, ju jeni idhujtarë!*” (En’amë, 121). Në tefsirin e tij të ajetit kur’anor të sures En’amë: “*Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni*” (En’amë, 153), thotë:

“Sheriati i kësaj feje është si besimi i saj për sa i përket konfirmimit të cilësive të idhujtarëve dhe cilësive të Islamit, madje sheriatit i saj ka të njëjtin kuptim si edhe besimi i saj, sheriatit i saj është besimi i saj, sepse është realitet objektiv i saj. Kjo e vërtetë esenciale vërehet qartë nga tekstet kur’anore dhe në metodën kur’anore. Kjo e vërtetë e ka lëvizur konceptin e “fesë” në shpirtrat e ithtarëve të kësaj feje shekuj me radhë në forma të ndryshme negative dhe të fëlliqura derisa përfundoi çështja për pjesën dërmuese të ambiciozëve të kësaj feje (edhe për armiq të që tallen) në ndarjen e çështjes së pushtetit nga çështja e besimit, dhe shpirtrat e tyre nuk lëvizin ashtu si lëvizë besimi, nuk e shijojnë fenë ashtu siç duhet, sepse bëjnë dallim në mes adhurimit dhe besimit. Kjo fe nuk njeh ndarjen në mes besimit, adhurimit dhe sheriatit. Këtë tronditje e kanë shkaktuar aparaturat speciale shekuj me radhë derisa përfundoi çështja e pushtetit në këtë formë të çuditshme, madje edhe për ambiciozët më të mëdhenj të kësaj feje! Në suren mekase nuk ka tematika të sistemit e as të sheriatit, por të besimit. Të gjitha këto ndikime dhe konfirmime e sfiduan aplikim parcial të traditave të jetës shoqërore, sepse kanë të bëjnë me një esencë të madhe, me esencën e pushtetit. Kjo esencë e madhe ndërlidhet me rregullën e kësaj feje dhe me ekzistencën e saj të vërtetë.

Ata që e akuzojnë idhujtarin për shirk e nuk e akuzojnë atë që mbështetet në djallin, ngushtohet nga e para, por jo edhe nga e dyta. Të tillët nuk e lexojnë Kur’anin dhe nuk e njohin natyrën e kësaj feje. Pra, le ta lexojnë Kur’anin ashtu siç e ka shpallur Zoti dhe le ta marrin fjalën e Zotit me seriozitet: “*Dhe nëse ju nënshtroheni atyre, ju jeni idhujtarë!*” (En’amë, 121). Disa “ambiciozë” të tillë të kësaj feje e preokupojnë veten dhe dijetarët me çështjet se a është ky ligj, kjo procedurë apo kjo thënie në përputhshmëri me sheriatin

⁵⁰ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur’an*, vëll. I, f. 407.

e Zotit apo jo, dhe kur shohin disa devijime mendojnë se Islami do të ekzistojë në mënyrë të plotë nëse pengohen devijimet e tilla!

Ambiciozët e tillë, xhelozë të kësaj feje, e dëmtojnë këtë fe pa vetëdije, bile e gjymtojnë fortë me interesimet e tyre anësore e të kota. Ata e harxhojnë energjinë e besimit të njerëzve me përqendrimet e tilla anësore e të kota dhe ofrojnë dëshmi të brendshme të situatave të tilla xhahilite. Ata dëshmojnë se kjo fe do të plotësohet nëse korrigjohen devijimet e tilla. Pra, feja përqendrohet vetëm në “ekzistencë” por jo edhe në sistem e situata, ku pushteti është vetëm i Zotit e jo i njerëzve”.⁵¹

Përfundimi dhe konkludimet

Falënderimi takon Zotit Një, të Fuqishmit, të Madhit, të Urtit, i cili me fuqinë dhe butësinë e Tij i përkrahë robërit e Tij të dobët e të shkelur deri në përfundimin e hulumtimeve të tyre dhe në kryerjen e punimeve të tyre dhe sikur të mos ishte mëshira dhe rahmeti i Zotit, nuk do të korrnim sukses!

Hapësira e lejuar e këtij hulumtimi përfundoi, dhe e tillë është natyra e punimeve shkencore që paraqiten nëpër simpoziume. Shumë herë dëmtojnë vlerën esenciale të diskutimit për shkak të shkrimit të paktë, madje edhe veten, prezantuesit dhe auditorin në salla për shkak të kohës së ngushtë të paraqitjes dhe shqyrtimit të temës. Duke i falënderuar Zotit arritëm në disa përfundime gjatë këtij studimi:

1. Studimi tregoi se gjenerata e parë e sahabëve dhe e tabi'inëve u dallua me metodën unike që mbështetej në mësim e përvetësim për të vepruar e jo vetëm për kënaqësi, studim e kulturë.

2. Studimi konfirmoi se njohuria duhet të shndërrohet në vepër e lëvizje dhe se duhet të deponohet vetëm në tru.

3. Ky studim sqaroi se shoqëria që nuk beson është organizim i gjallë që lëvizë si një organ i vetëm dhe se duhet t'i kundërvihemi në të njëjtën mënyrë, metodë e projekt.

4. Studimi vërtetoi se lidhja e besimit është hyrje dhe se preferohet nga lidhjet e tjera shoqërore.

5. Studimi argumentoi se besimi islamik është si themeli i shtëpisë, sepse nuk mund të realizohet me urdhrat, parimet dhe dispozitat e shariatit përpos nëse depërton së pari besimi më zemrat e muslimanëve.

Dhe në fund, Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve.

⁵¹ Kutub, Sejjid, *Fi dhilalil-Kur'an*, vëll. 3, fq. 1216-1217.

LITERATURA

1. El-Halidij, Salah Abdulfettah, Amerika mine-dahil bi mindhari Sejjid Kutub, Darul- Kalem, bot. VIII, Damask 2002.
2. Zervak, Nusajr, Mekasidush-sheriatil-islamijjeti fi fikril-imam Sejjid Kutub, Darus-salam, bot. I, Kajro 2009.
3. El-Kardavij, Jusuf, Kejfe neteamelu me'al-Kur'an, Darush-shuruk, bot. I, Kajro 1999.
4. Kutub, Sejjid, El-Mustekbelu li hadhaddin el-it-tikadul-islamij el-alemij lil-munedh-dhematit-tul-labijjeti, bot. I, 1988.
5. Kutub, Sejjid, Hasaisut-tesavvuril-islamij ve mukavvimatuhu, Darush-shuruk, bot. III, Kajro 1996.
6. Kutub, Sejjid, Fi Dhilalil-Kur'an, Darush-shuruk, bot. II, 1980, Kajro (Burimi kryesor i hulumtimit).
7. Kutub, Sejjid, Mealim fit-tarik, Darul-kalem, bot. III, Bejrut 2001.
8. Kutub, Sejjid, Mukavvimatut-tesavvuril-islamij, Darush-shuruk, bot. IV, Kajro 1998.
9. Musnedi i Imam Ahmedit, tahkikush-shejh Shuajb El-Arnauti ve Adil Murshid, muessesetur-risaleti, bot. I, 2001.
10. En-Nevevij, Jahja Sherefuddin, Sahihul-Imam Muslim bi sherhin, Darul-Kalem, bot. II, Bejrut 2003.
11. Jusuf, Muhamed Hasan, Es-Safhatus-seuda lil-kitabil-mukaddes, Darul-kitabil-arabij, bot. I, Kajro 2006.